


VENDIM  
I  
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 27.01. 2007, unë , gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Av. Jola GJUZI në cilësinë e Përfaqësueses së autorizuar të Shoqërisë Oracle Nederland B.V. në Shqipëri, për regjistrimin e Zyrës së Përfaqësisë,

**KONSTATOVA SE:**

Shoqëria Oracle Nederland B.V. ("Shoqëria"), është një shoqëri e themeluar dhe që zhvillon aktivitetin e saj sipas të drejtës së Hollandës, e themeluar më 28 Gusht 1984 dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Dhomës së Tregtisë me numër regjistrimi nr. 30096087, me seli statutore në De Meern dhe adresë kryesore të kryerjes së aktivitetit në Rijnszathe 6, 3454PV De Meern, Hollandë.

Më 22 Janar 2007, anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë Oracle Nederland B.V., përkatësisht Z. Marcel A.J.J. van de Molen, Z. Mark J. Pickett dhe Z. Michael G. O'Callaghan, u mbledhën në një mbledhje në selinë e shoqërisë në adresën: Rijnszathe 6, 3454PV De Meern, Hollandë, për të vendosur për themelimin e një zyre përfaqësie të Shoqërisë në Shqipëri.

Konkretisht ata vendosën:

1. Themelimin e një Zyre Përfaqësie të Shoqërisë në Shqipëri e cila do të regjistrohet dhe zhvillojë veprimtarinë e saj sipas ligjeve të Shqipërisë.
  - a. Emri i Zyrës së Përfaqësisë do të jetë: Oracle Nederland B.V. Albania Representative Office - Oracle Nederland B.V. Zyra e Përfaqësisë Shqipëri.
  - b. Selia e Zyrës së Përfaqësisë do të jetë në adresën: Rruga e Kavajës, Tirana Tower, Nr. 59, Kati 5, Tiranë, Shqipëri.
  - c. Objekti i veprimtarisë së Zyrës së Përfaqësisë do të jetë: kryerja e kërkimeve të tregut dhe aktiviteteve për zhvillimin e biznesit; zbatimi i aktiviteteve promovionale, informative dhe të marketingut; kryerja e aktiviteteve përgatitore dhe ndihmëse për marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat e tjera.
  - d. Kohëzgjatja e Zyrës së Përfaqësisë do të jetë e pacaktuar.
  - e. Administrator i Zyrës së Përfaqësisë do të jetë Z. Alban Çausi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25.03.1973, mbajtës i pasaportës nr. Z1351614.

Njëkohësisht ata vendosën caktimin e zyrës së avokatisë Kalo & Associates, veçanërisht Znj. Jola Gjuzi, Znj. Vilma Gjyshi, Znj. Jonida Lakuriqi, Znj. Hilda Mezini dhe Znj. Majlinda Kraja, të cilat bashkërisht ose veç e veç do të ndërmarrin çdo procedurë, përgatisin çdo dokument dhe nënshkruajnë çdo kërkesë apo dokument drejtuar Regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Tiranës si dhe çdo institucioni tjetër shtetëror si Dhoma e Tregtisë, Bashkia, Zyra e punës dhe Zyra e Tatimeve vetëm për qëllim të regjistrimit së Zyrës së Përfaqësisë.

## PËR KËTO ARSYE:


Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, dhe

### VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës;
2. Regjistrimin në Regjistrin Tregtar të Zyrës së Përfaqësisë së shoqërisë Oracle Nederland B.V. me të dhënat e mëposhtme:
  - a. Emri i Zyrës së Përfaqësisë do të jetë: **Oracle Nederland B.V. Albania Representative Office - Oracle Nederland B.V. Zyra e Përfaqësisë Shqipëri.**
  - b. Selia e Zyrës së Përfaqësisë do të jetë në adresën: **Rruga e Kavajës, Tirana Tower, Nr. 59, Kati 5, Tiranë, Shqipëri.**
  - c. Objekti i veprimtarisë së Zyrës së Përfaqësisë do të jetë: **kryerja e kërkimeve të tregut dhe aktiviteteve për zhvillimin e biznesit; zbatimi i aktiviteteve promociionale, informative dhe të marketingut; kryerja e aktiviteteve përgatitore dhe ndihmëse për marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat e tjera.**
  - d. Kohëzgjatja e Zyrës së Përfaqësisë do të jetë **e pacaktuar.**
  - e. Administrator i Zyrës së Përfaqësisë do të jetë **Z. Alban Çausi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25.03.1973, mbajtës i pasaportës nr. Z1351614.**
3. Depozitim në Regjistrin Tregtar të akteve shoqëruese përkatësisht të:
  - a. Akti i themelimit të Shoqërisë datë 28 Gusht 1984;
  - b. Akti i ndryshimit të Statutit të Shoqërisë datë 28 Nëntor 1989;
  - c. Akti i ndryshimit të Statutit të Shoqërisë datë 24 Dhjetor 2001;
  - d. Akti i ndryshimit të Statutit të Shoqërisë datë 5 Nëntor 2004;
  - e. Statuti përfundimtar i Shoqërisë sipas ndryshimeve të mësipërme sipas Vërtetimit noterial datë 24 Janar 2007;
  - f. Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Dhomës së Tregtisë Utrecht, datë 11 Janar 2007
  - g. Vërtetim nga Gjykata e Utrechtit për gjendjen ekonomike të Shoqërisë datë 15 Janar 2007;
  - h. Vendim i Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë datë 22 Janar 2007 për themelimin e Zyrës së Përfaqësisë në Shqipëri (përfshirë edhe autorizimi për Zyrën e Avokatisë Kalo & Associates [pika (f) e Vendimit].

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
Nr. 37618/1

VENDIM  
I  
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 07-06-2007, unë M. Lleshi, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Av. Jola GJUZI në cilësinë e Përfaqësueses së autorizuar të Shoqërisë Oracle Nederland B.V. në Shqipëri, për regjistrimin e Zyrës së Përfaqësisë,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Oracle Nederland B.V. ("Shoqëria"), është një shoqëri e themeluar dhe që zhvillon aktivitetin e saj sipas të drejtës së Hollandës, e themeluar më 28 Gusht 1984 dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Dhomës së Tregtisë me numër regjistrimi nr. 30096087, me seli statutore në De Meern dhe adresë kryesore të kryerjes së aktivitetit në Rijnzathe 6, 3454PV De Meern, Hollandë.

Me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 37618, datë 27.02.2007 është vendosur regjistrimi në Regjistrin tregtar i Zyrës së Përfaqësisë **Oracle Nederland B.V. Albania Representative Office - Oracle Nederland B.V. Zyra e Përfaqësisë Shqipëri**.

Më 23 Maj 2007, Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë Mëmë Oracle Nederland B.V. është mbledhur në selinë e Shoqërisë me të pranishëm tre anëtarët e tij:

1. Z. Marcel A.J.J. van de Molen
2. Z. Mark J. Pickett
3. Z. Val J. Maher.

Bordi i Drejtorëve ka vendosur:

1. Të ndryshojë selinë dhe administratorin e Oracle Nederland B.V. Albania Representative Office (Oracle Nederland B.V. Zyra e Përfaqësisë Shqipëri), regjistruar më 27.02.2007 me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 37618.

- a. Selia e Zyrës së Përfaqësisë do të ndryshohet nga adresa aktuale në Rruga e Kavajës, Tirana Tower, Ne. 59, Kati 5, Tiranë, Shqipëri në adresën e mëposhtme: **Bulevardi Bajram Curri, European Trade Center (ETC), Nr. 4, Kati 14, Tiranë, Shqipëri, duke filluar që prej datës 11.04.2007.**
- b. Administratori i Zyrës së Përfaqësisë do të ndryshohet nga administratori aktual Alban Caushi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25.03.1973, mbajtës i pasaportës nr. Z1351614 në **Albert Kola, shtetas shqiptar, lindur në Burrel, më 26.09.1966, mbajtës i pasaportës nr. 1824690, duke filluar që prej datës 1 Qershor 2007.** Administratori do të ketë të drejtë të përfaqësojë Zyrën e Përfaqësisë në Republikën e Shqipërisë përpara palëve të treta në veprimtaritë e Zyrës së Përfaqësisë që janë kryerja e kërkimeve të tregut dhe aktiviteteve për zhvillimin e biznesit; kryerja e kërkimeve të tregut dhe aktiviteteve për zhvillimin e

biznesit; zbatimimi i aktiviteteve promociionale, informative dhe të marketingut; kryerja e aktiviteteve përgatitore dhe ndihmëse për marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat e tjera. Ai do të ketë të drejtën të përfaqësojë Zyrën e Përfaqësisë përpara të gjithë autoriteteve qeveritare ose jo si dhe të gjithë gjykatave si dhe të përfundojë marrëveshje lidhur me prokurimet, qiradhënien e qiramarrjen e të mirave dhe shërbimeve të nevojshme për veprimtarinë e Zyrës së Përfaqësisë deri në një vlerë kontrate prej 1000 EURO. Pavarësisht nga sa më lart, kompetencat e mëposhtme do t'i përkasin organeve të shoqërisë Oracle Nederland B.V. siç përcaktohet në statutin e saj: lidhja, ndryshimi dhe mbarimi i kontratave të punës; lidhja, ndryshimi dhe mbarimi i marrëveshjeve të qirasë apo shitjes së pasurive të paluajtshme; prokurimi, qiradhënia ose qiramarrja e të mirave dhe shërbimeve në një vlerë më të madhe se 1000 EURO.

- c. Të caktojë zyrën e avokatisë Kalo & Associates, veçanërisht Znj. Jola Gjuzi, Znj. Vilma Gjyshi, Znj. Jonida Lakuriqi, Znj. Hilda Mezini, Znj. Majlinda Kraja të cilat bashkërisht ose veç e veç do të ndërmarrin të gjithë procedurat, përgatisin çdo dokument dhe nënshkruajnë çdo aplikim në Regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Tiranës si dhe në organet e tjera shtetërore si Dhoma e Tregtisë, Bashkia, zyra e punës dhe zyra e tatimeve me qëllim pasqyrimin e ndryshimit në regjistrimin e Zyrës së Përfaqësisë sipas këtij Vendimi.

#### PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", dhe

#### VENDOSA:


1. Pranimin e kërkesës;
2. Depozitimimin në skedën përkatëse të Zyrës së Përfaqësisë së shoqërisë Oracle Nederland B.V. me emrin Oracle Nederland B.V. Albania Representative Office - Oracle Nederland B.V. Zyra e Përfaqësisë Shqipëri në Regjistrin Tregtar, të Vendimit të Bordit të Drejtorëve datë 23 Maj 2007 për:
  1. Ndryshimin e selisë dhe administratorit të Oracle Nederland B.V. Albania Representative Office (Oracle Nederland B.V. Zyra e Përfaqësisë Shqipëri), regjistruar më 27.02.2007 me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 37618.
  - a. Selia e Zyrës së Përfaqësisë do të ndryshohet nga adresa aktuale në Rruga e Kavajës, Tirana Toëer, Ne. 59, Kati 5, Tiranë, Shqipëri në adresën e mëposhtme: **Bulevardi Bajram Curri, European Trade Center (ETC), Nr. 4, Kati 14, Tiranë, Shqipëri, duke filluar që prej datës 11.04.2007.**
  - b. Administratori i Zyrës së Përfaqësisë do të ndryshohet nga administratori aktual Alban Caushi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25.03.1973, mbajtës i pasaportës nr. Z1351614 në **Albert Kola, shtetas shqiptar, lindur në Burrel, më 26.09.1966, mbajtës i pasaportës nr. 1824690, duke filluar që prej datës 1 Qershor 2007.** Administratori do të ketë të drejtë të përfaqësojë Zyrën e Përfaqësisë në Republikën e Shqipërisë përpara palëve të treta në veprimtaritë e Zyrës së Përfaqësisë që janë kryerja e kërkimeve të tregut dhe aktiviteteve për

zhvillimin e biznesit; kryerja e kërkimeve të tregut dhe aktiviteteve për zhvillimin e biznesit; zbatimimi i aktiviteteve promovionale, informative dhe të marketingut; kryerja e aktiviteteve përgatitore dhe ndihmëse për marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat e tjera. Ai do të ketë të drejtën të përfaqësojë Zyrën e Përfaqësisë përpara të gjithë autoriteteve qeveritare ose jo si dhe të gjithë gjykatave si dhe të përfundojë marrëveshje lidhur me prokurimet, qiradhënien e qiramarrjen e të mirave dhe shërbimeve të nevojshme për veprimtarinë e Zyrës së Përfaqësisë deri në një vlerë kontrate prej 1000 EURO. Pavarësisht nga sa më lart, kompetencat e mëposhtme do t'i përkasin organeve të shoqërisë Oracle Nederland B.V. siç përcaktohet në statutin e saj: lidhja, ndryshimi dhe mbarimi i kontratave të punës; lidhja, ndryshimi dhe mbarimit i marrëveshjeve të qirasë apo shitjes së pasurive të paluajtshme; prokurimi, qiradhënia ose qiramarrja e të mirave dhe shërbimeve në një vlerë më të madhe se 1000 EURO.

- c. Caktimin e zyrës së avokatisë Kalo & Associates, veçanërisht Znj. Jola Gjuzi, Znj. Vilma Gjyshi, Znj. Jonida Lakuriqi, Znj. Hilda Mezini, Znj. Majlinda Kraja të cilat bashkërisht ose veç e veç do të ndërmarrin të gjithë procedurat, përgatisin çdo dokument dhe nënshkruajnë çdo aplikim në Regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Tiranës si dhe në organet e tjera shtetërore si Dhoma e Tregtisë, Bashkia, zyra e punës dhe zyra e tatimeve me qëllim pasqyrimin e ndryshimit në regjistrimin e Zyrës së Përfaqësisë sipas këtij Vendimi.
3. Pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të Zyrës së Përfaqësisë në Regjistrin tregtar.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

GJYQTARE



Më njëzetë e tetë gusht një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër, u shfaqën para meje Bart Theodoor Derogee, Noter, ushtrues i këtij profesioni në Rotterdam:

Z. Tapio Juhani Makinen, jurist në Finlandë, me seli në Rotterdam dhe për qëllim të këtij akti vepron si më poshtë:

- a. si avokat i autorizuar me shkrim i Oracle Corporation të Menlo Park, Kaliforni, USA dhe;
- b. si një person privat.

I paraqituri i cili vepron si më sipër deklaroi këtu të formojë një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e cila do të qeveriset nga rregullat e mëposhtme:

## STATUT

### EMRI DHE VENDODHJA E SHOQËRISË

#### Neni 1

1. Emri i Shoqërisë është Orce System Software B.V.
2. Selia e shoqërisë është në Naarden.

#### Neni 2

Objekt i shoqërisë është:

- a. të bëjë biznes në fushën EDP (Elektrik Data Processing) përpunim i të dhënave elektrike përfshirë tregtinë dhe me to dhe zhvillimin e programeve software dhe deh shërbimet e lidhura me to;
- b. të marrë pjesë në financimin ose të marrë interesat në çdo mënyrë tjetër dhe të drejtojë menaxhimin e bizneseve të tjera dhe të angazhohet për detyrimet e sipërmarrjeve me të cilat është përfshirë së bashku me shoqëri të tjera në grup; dhe
- c. të kryejë çdo veprimtari që në kuptimin e gjerë të fjalës është e lidhur me objektet e sipër përmendura ose që mund të çojnë në të njëjtat përfundime.

### KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

#### Neni 3

1. Kapitali themeltar i caktuar i shoqërisë i ndarë në formë aksionesh kap një shumë prej njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë Gulden holandez (175,000.00), shumë e cila ndahet në njëqind e shtatëdhjetë e pesë (175) aksione secili me një vlerë nominale prej një mijë Guldenë holandez (1,000.00) ku prej këtyre tridhjetë e pesë (35) aksione janë nënshkruar.
2. Aksionet do të lëshohen vetëm nën detyrimin që ato të paguhen plotësisht dhe asnjëherë nën vlerën e tyre nominale.
3. Aksionet të cilat nuk janë nënshkruar ende kanë mundësinë për t'u emetuar duke u mbështetur në vendimin dhe në kushtet dhe afatet që do të caktohen në Mbledhjet e përgjithshme të Aksionarëve.
4. Shoqëria do të ketë të drejtën, sipas përcaktimit të bërë nga Ligji, të përvetësojnë aksione të paguara plotësisht në kapitalin e vet aksionar në vlerën, por vetëm vlerën më të lartë se një maksimum i vlerës nominale, i barabartë me gjysmën e

kapitalit aksionar të nënshkruar. Për aksionet në kapitalin e vetë aksionar të mbajtura prej shoqërisë, asnjë e drejtë e që i është bashkëngjitur aksioneve do të jetë e mundur të ushtrohet nga shoqëria; ato nuk do të numërohen për qëllimet e llogaritjes së një mazhorance prezentë ne kuorum.

5. Përvetësimi dhe kalimi i aksioneve që shoqëria ka në kapitalin e saj themeltar do të bëhet me anë të një vendimi dhe sipas kushteve që do të vendosen në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve.
- 6 Kur kalimmi i aksioneve të shoqërisë nga kapitali I saj themeltarklauzolat prej ketej në lidhje me ceshtjete aksioneve ende jo të nënshkruara duhet të jene të aplikueshme. Cfare është përfituar nga neni 5 për këtë nuk do të aplikohet për ndonjë transfertë.
7. Shoqëria nuk duhe ta shtrijë kooperimin e saj në ceshtjet dëftesat e depozitave për aksionet në aksionet e kapitalit të saj themeltar.
8. Tagrat për akordimin e të dretave të votimit mbi ata që kanë një të drejtë uzufukti ose një e drejtën e pengut është përjashtuar.

#### Neni 4

1. Aksionet duhet të jenë të regjistruara dhe sirtjedhojë dhe të numëruara. Asnjë certifikatë aksioni nuk duhet lëshuar.
  2. Bordi I manaxhimit duhet të mbajë një regjistër për aksionet e në zyrën e shoqërisë, në të cilën me lidhjen e cdo aksioni të shënojë dhe emrin dhe adresën e cdo aksionari, duke regjistruar dhe shumën e paguar për co aksion, dhe gjithashtu të aplikueshme deri tani vecantit e më tejshme referuar Nenit 154 të kreut 2 të Kodit Civil.
- Cdo aksionar duhet të ketë detyrimin të japë njoftimin me shkrim të një adrese bordit të manaxhimit.
3. Cdo hyrje e regjistruar në regjistër duhet të nënshkruhet nga dretori I manaxhimit; regjistri duhet të mbahet I informuar.
  4. Aksionet mund të transferohen dhe me anë të shërbimit të një instrumenti transferiminë shoqëri nga një Përmbarues gjykate se nga një dëftese me shkrim nga shoqëria e transferimit duke u mbëahtetur në produktin e atij instrumenti të shoqërisë.

#### Neni 5

1. Transferimi aksioneve mund të jetë I mundur vetëm mbas miratimit të përfituar nga mbledhja e zakonmee aksionarëve.
2. Transferimi duhet të kalohet brenga tre muajve nga aprovimi është garantuar ose është quajtur I garantuar.
3. Aprovimi do të jetë quajtur se është garantuar nëse nuk është marrë asnjë vendim brenda një muaji me lidhjen e një kërkesë për këtë efekt, ose më tepër nëse mbledhja e përgjithshme e aksionarëve nuk duhet, njëkoësisht me refuzimin e miratimit të aksionarit i cili ka bërë kërkesë për këtë miratim, emrin ose emrat e blerëve të interesuar të cilët janë të përgatitur për të blerë të gjitha aksionet është e lidhur kërkesa për këtë miratim, përkundrejt pagesës me para në dorë.
4. Nëse aksionari, i cili ka bërë kërkesën për këtë miratim, pranon blerjet e interesuara të referuara ne paragrafin 3 të këtij teksti dhe palët nuk mund të lidhin një marrëveshje në lidhje me çmimin që duhet të paguhet për blerjen e një aksioni ose të gjitha aksionet, kështu çmimi nëse vendoset kështu do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i regjistruar, që do të caktohet nga me marrëveshje të heshtur

midis palëve, dhe nëse ata nuk arrijnë të merren vesh për të, eksperti duhet të caktohet nga presidenti i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së fushës në të cilën shoqëria ushtron veprimtarinë e saj siç është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shpenzimet për përcaktimin e çmimit do të jenë në ngarkim të shoqërisë.

5. Blerësit e interesuar do të kenë të drejtën që në çdo kohë të tërhiqen, duke marrë parasysh që kjo mund të bëhet brenda 14 ditëve pas caktimit të çmimit siç përcaktohet në paragrafin paraardhës, që i është njoftuar atyre. Nëse si rezultat i sa u përmend më sipër jo të gjitha aksionet kanë arritur të shiten:
  - a. për shkak se blerësit e interesuar janë tërhequr, ose
  - b. për shkak se blerësit e tjerë të interesuar, brenda gjashtë javëve pas njoftimit të referuar më sipër, kanë deklaruar se dëshirojnë të marrin aksionet të cilat kështu bëhen të disponueshme, sipas një vëzhgimi të përshtatshëm të standardit për shpërndarje të përcaktuar nga Mbledhja e Përgjithshme e aksionarëve, më tej aksionarët të cilët kanë bërë një kërkesë për një miratim të tillë do të jenë të lirë të transferojnë të gjitha aksionet për të cilat bëhet fjalë në kërkesën për miratim, duke siguruar se transferimi do t'i kalojë brenda tre muajve pasi situata është bërë e qartë.
6. Aksionari i cili ka bërë një kërkesë për një miratim të tillë do të ketë të drejtën për t'u tërhequr në çdo kohë, por jo më tepër se një muaj nga momenti që atij i është bërë përfundimisht e njohur, se cilit blerës të interesuar ai mund t'i shesë aksione sipas kërkesës që ka bërë dhe në lidhje me çmimin të përcaktuar.
7. Shoqëria do të jetë e vetmja përgjegjëse për të qenë një blerës i interesuar sipas kushteve dhe parashikimeve të këtij neni, dhe me lejen e aksionarit i cili ka bërë kërkesën për një miratim të tillë.

#### MENAXHIMI DHE MBIKQYRJA

##### Neni 6.

1. Shoqëria do të ketë një bord të menaxhimit që do të përbëhet nga një ose më shumë persona, dhe një bord mbikëqyrës që po ashtu do të përbëhet nga një ose më shumë persona.
2. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve do të do të caktojë numrin e drejtorëve të menaxhimit dhe drejtorëve të mbikëqyrjes.
3. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve do të do të caktojë numrin e drejtorëve të menaxhimit dhe drejtorëve të mbikëqyrjes dhe do të ketë të drejtë të shkarkojë dhe pezullojë në çdo kohë secilin prej drejtorëve të menaxhimit dhe drejtorëve të mbikëqyrjes.
4. Një person i cili ka arritur në moshën e shtatëdhjetë e dy viteve nuk do të mund të konsiderohet i vlefshëm për t'u zgjedhur dhe emëruar si drejtor mbikëqyrës. Një drejtor mbikëqyrës do të heqë dorë jo më vonë se dita në të cilën Mbledhja Vjetore e Përgjithshme e Aksionarëve të jetë mbajtur, në vitin financiar në të cilin ai ka arritur moshën shtatëdhjetë e dy vjet.
5. Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve do të caktojë shpërblimin, afatet dhe kushtet e mëtejshme të punësimit të secilit prej drejtorëve menaxhues dhe do të ketë fuqi për të garantuar shpërblimin e njërit drejtor, ose secilit prej tyre.

#### BORDI I MENAXHIMIT

##### Neni 7



1. Sipas kufizimeve të parashikuar në statutin e shoqërisë bordi i menaxhimit do të jetë i ngarkuar me menaxhimin e punëve të shoqërisë.
2. Bordi i menaxhimit do të ketë detyrimin për të vepruar në përputhje me udhëzimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve duke iu referuar drejtimeve të përgjithshme të politikës financiare, shoqërore dhe ekonomik, dhe kështu edhe për politikën në lidhje me burimet njerëzore të shoqërisë.
3. Bordi i menaxhimit duhet të marrë miratimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve për vendime të tilla në lidhje me menaxhimin e shoqërisë dhe po ashtu, Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve mundet posaçërisht të deklarojë me vendim për këtë qëllim.
4. Secili prej Drejtorëve menaxhues do të përfaqësojë ligjërisht shoqërinë.
5. Në rastin e një parandalimi ose mungese të përhershme të njërit prej drejtorëve menaxhues, të gjithë ose njëri prej drejtorëve të mbetur do të jenë të ngarkuar me për menaxhimin e të gjitha punëve të shoqërisë. Në rastin e një parandalimi ose mungese të përhershme të të gjithë drejtorëve, ose të drejtorit të vetëm të shoqërisë, një ose më tepër persona që do të caktohen nga bordi për këtë qëllim, do të menaxhojnë përkohësisht punët shoqërisë.

## BORDI MBIKËQYRËS

### Neni 8

1. Do të jetë detyrim i Bordit Mbikëqyrës të ushtrojë mbikëqyrjen mbi punën e Bordit të Menaxhimit dhe mbi mbarëvajtjen e përgjithshme të biznesit të shoqërisë dhe sipërmarrjet e biznesit të lidhura me të.
2. Bordi i menaxhimit do të pajisë me të gjithë informacionin në lidhje me punët e shoqërisë secilin prej drejtorëve të bordit mbikëqyrës sipas kërkesave të këtij të fundit. Bordi Mbikëqyrës do të ketë fuqinë të analizojë të gjithë librat, shënimet, dokumentet dhe korrespondencën e shoqërisë, të mbajë stoqe të garancive të përdorshme që i përkasin shoqërisë dhe të mbajë dijeni për të gjitha veprimet që kanë ngjarë; çdo drejtor mbikëqyrës do të ketë të drejtën e hyrjes në të gjitha godinat dhe vendet të cilat përdoren nga shoqëria.
3. Bordi Mbikëqyrës do të ketë fuqi të thërrasë për ndihmën e ekspertëve në ushtrimin e detyrave të tij, me shpenzimet e shoqërisë.
4. Nëse Bordi Mbikëqyrës përbëhet nga më tepër sesa një anëtarë, mbledhja e përgjithshme e aksionarëve do të caktojë njërin prej tyre si kryetar dhe do të ketë të drejtën të caktojë një ose më tepër prej Drejtorëve Mbikëqyrës të Deleguar, të cilët do të jenë të caktuar posaçërisht për mbikëqyrjen e përditshme të veprimeve të Bordit të menaxhimit.
5. Bordi Mbikëqyrës do të mblidhet sa herë që shumica e anëtarëve të Bordit të bordit ose kryetari i saj ta konsiderojë të nevojshëm. Mbledhjet e Bordit do të thirren sipas çështjeve të cilat duhet të trajtohen, nga kryetari i bordit mbikëqyrës dhe në rastin e parandalimit të tij, ose të mungesës së përhershme të njërit prej drejtorëve të bordit mbikëqyrës gjatë një periudhe ku është vënë re mungesa e tij prej të paktën tetë ditëve. Drejtorët mbikëqyrës do të kenë të drejtën për t'u përfaqësuar nga çdo anëtar tjetër i bordit mbikëqyrës, përmes një autorizimi me shkrim.
6. Bordi Mbikëqyrës do të ketë në mënyrë alternative të drejtën të marrë vendime pa mbajtur një mbledhje me kusht që vendimi të merret me shkrim, telegraf ose

- telex, dhe duke u siguruar që të gjithë drejtorët mbikëqyrës të jenë këshilluar për vendimin e marrë dhe me kusht që asnjëri prej tyre të jetë në kundërshtim me faktin që vendimi të merret në këtë mënyrë.
7. Bordi Mbikëqyrës do t'i miratojë vendimet e veta në një mbledhje dhe po ashtu edhe pa mbajtur një mbledhje me një shumicë absolute të votave të gjithë drejtorëve mbikëqyrës në detyrë.
  8. Të gjitha vendimet e Bordit Mbikëqyrës duke përfshirë ato të cilat janë miratuar sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin 6 të këtij akti, duhet të mbahen shënim në një regjistër të posaçëm.
  9. Kur shoqëria dëshiron të ketë një provë të ndonjë vendimi të Bordit Mbikëqyrës të saj, nënshkrimi i njërit prej drejtorëve në dokument do të jetë i mjaftueshëm për efekt provueshmërie.
  10. Pa paragjykim për sa parashikohet në nenet 6 paragrafi 5 i këtij akti, shpenzimet e bëra nga anëtarët e Bordit Mbikëqyrës për shkak të detyrës do të rimbursohet nga shoqëria.
  11. Bordi Mbikëqyrës do të ketë fuqi të pezullojë çdo drejtorë menaxhues. Duhet t'i jepet menjëherë njoftim me shkrim drejtorit menaxhues në lidhje me këtë pezullim, duke përfshirë aty edhe arsyen e pezullimit dhe ekziston detyrimin për thirrjen e një Mbledhjeje të Përgjithshme të Aksionarëve, në të cilën do të vendoset nëse pezullimi do të lihet në fuqi, apo do të anulohet.
  12. Çdo vit njëri prej drejtorëve mbikëqyrës do të tërhiqet sipas një rregulloreje që do të hartohet nga Bordi Mbikëqyrës. Ai i cili ka dhënë dorëheqjen do të jetë kandidat i mundshëm për t'u zgjedhur për një ri-emërim, përveç se në rastin kur ai ka mbushur ose do të mbushë moshën shtatëdhjetë e dy vjeçare gjatë vitit financiar në të cilin mbahet mbledhja. Ai i cili e ka mbushur moshën shtatëdhjetë e dy vjeçare nuk do të mund të zgjidhet si drejtor i Bordit Mbikëqyrës. Një drejtor mbikëqyrës duhet të japë dorëheqjen jo më vonë se një ditë në të cilën mbahet një mbledhje e përgjithshme vjetore në vitin financiar në të cilin ai mbush moshën shtatëdhjetë e dy vjeçare.
  13. Nëse për ndonjë arsye apo për një tjetër një ose më tepër drejtorë mbikëqyrës do të mungojnë në mënyrë të përhershme, drejtorët e mbetur mbikëqyrës, por aq kohë sa të paktën njëri prej drejtorëve mbikëqyrës të jetë në detyrë, do të përbëjnë një trup të aftë për të vepruar deri në mbledhjen e përgjithshme vjetore të ardhshme të aksionarëve, të cilët më tej do të vendosin për mbushjen e vendeve vakante, ose mund të vendosin që vendi/vendet të mbeten vakant/e.
  14. Nëse do të mbetet vetëm një drejtor i vetëm mbikëqyrës atëherë atij do t'i mbeten të gjitha të drejtat dhe detyrimet të cilat statuti i shoqërisë ia akordon dhe imponon Bordit Mbikëqyrës dhe kryetarit të tij.

#### MBLEDHJET E PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE

##### Neni 9

1. Çdo vit do të mbahet të paktën një mbledhje e përgjithshme e aksionarëve, ajo do të mbahet brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.
2. Mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve do të mbahen në vendin ku shoqëria ka selinë e saj të përcaktuar në Statut, dhe do të thirret nga Bordi Menaxhues ose nga Bordi Mbikëqyrës me njoftim përmes letrave të regjistruara të cilat duhet t'i

dërgohen të paktën brenda 14 ditëve, pa përfshirë këtu ditën në të cilën mbledhja është thirrur dhe ditën në të cilën mbledhja është mbajtur.

3. Nëse parashikimet bëhen të pavlefshme nga ligji, apo nga statuti, në lidhje me thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve si dhe në lidhje me përcaktimin e rendit të mbledhjes dhe në lidhje me vënien në shqyrtim të çështjeve me të cilat duhet të përballeshin dhe për të cilat nuk kanë rënë dakord, vendimet e vlefshme do të jenë megjithatë të tilla për t'u miratuar duke siguruar që i gjithë aksioni themeltar i nënshkruar të përfaqësohet në mbledhjen në fjalë dhe duke siguruar që vendimi të miratohet me votë unanime.

#### Neni 10

1. Mbledhja e Përgjithshme e aksionarëve do të vendosë vetë se cili do të jetë personi që do ta drejtojë mbledhjen.
2. Çdo aksion do të përmbajë të drejtën për të hedhur një votë.
3. Të gjitha vendimet do të miratohen me një shumicë absolute të votave të vlefshme të hedhura.

#### Neni 11

Vendimet e aksionarëve, në vend që të miratohen në mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve, në mënyrë alternative do të jenë të vlefshme për t'u miratuar me shkrim duke përfshirë këtu telegrame dhe mesazhe-telex, duke siguruar që ato të miratohen gjithashtu me shumicën e votave të të gjithë aksionarëve të cilët kanë të drejtën e votës.

#### VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

#### Neni 12

1. Viti financiar i shoqërisë do të nisë që në ditën e parë të muajit Qershor e në vazhdim, deri duke përfshirë edhe ditën e njëzetë e një të muajit Maj.
2. Bordi i menaxhimit duhet të mbyllë shënimet e shoqërisë që në ditën e fundit të çdo viti financiar dhe brenda pesë muajve do të hartojë më tej llogaritë vjetore dhe një memorandum sqarues dhe do t'i paraqesë këto dokumente në mbledhjen e përgjithshme për konfirmim dhe miratim.
3. Llogaritë vjetore do të nënshkruhen nga të gjithë drejtorët menaxhues dhe të gjithë drejtorët mbikëqyrës; në rastin e mungesës së ndonjërit prej nënshkrimeve, i përmenduri do të do të paraqitet më tej gjatë llogarisë vjetore, duke vendosur edhe arsyen.
4. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve do të konfirmojë dhe miratojë llogaritë vjetore; ky konfirmim dhe miratim do të përbëjë edhe shkarkimin nga përgjegjësia për drejtorët menaxhues dhe drejtorët mbikëqyrës në lidhje me të gjitha veprimet që paraqiten përmes këtyre dokumenteve, ose rezultatet e të cilave janë të trupëzuara aty, përveç rastit kur një kusht është bërë në mënyrë eksplicite dhe pa asnjë paragjykim me atë që është parashikuar apo do të parashikohet për të në ligj.

#### Neni 13

1. Fitimet e treguara në llogaritë vjetore, të konfirmuara dhe miratuara do të jenë në dispozicion të mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve.
2. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve do të ketë të drejtën të bëjë të pagueshme një ose më shumë prej të dividendëve të brendshëm, në një shumë të tillë sa janë

edhe fitimet dhe në atë shumë që mund të lejohet pagimi i dividendëve të brendshëm.

3. Nëse llogaritë vjetore të çdo viti, të konfirmuara dhe të miratuara do të tregojnë se ka pasur një humbje e cila nuk plotësohet nga asnjë rezervë apo nuk është kthyer në të mira në ndonjë formë tjetër, atëherë nuk do të bëhet asnjë shpërndarje e fitimeve në vitin pasardhës, për aq kohë sa kjo humbje nuk është rikuperuar.

## FALIMENTIMI DHE LIKUIDIMI

### Neni 14

1. Në rastin kur shoqëria vihet në likuidim ajo do të shpallet e falimentuar nga bordi i menaxhimit nën mbikëqyrjen e bordit mbikëqyrës, përveç rastit kur mbledhja e përgjithshme e aksionarëve do të vendosë ta zgjidhë ndryshe.
2. Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve do të përcaktojë shpërblimin e likuidatorëve dhe të atyre të cilët janë ngarkuar me mbikëqyrjen procesit të likuidimit.
3. Gjatë likuidimit statuti i shoqërisë për aq kohë sa të jetë e mundur do të mbetet në fuqi dhe plotësisht e vlefshme.
4. Çfarëdo që të mbetet nga pasuria e shoqërisë pasi të gjitha borxhet e saj të jenë shlyer, do të shpërndahet në mënyrë të barabartë aksionarëve në proporcion me aksionet që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

Personat e paraqitur së fundmi deklaruan si më poshtë:

- a. Shoqëria Oracle Corporation do të marrë pjesë në tridhjetë e katër (34) aksione të kapitalit të shoqërisë dhe Zoti Tapio Juhani Makinen do të marrë pjesë në një (1) aksion të kapitalit të shoqërisë;
- b. Të gjitha aksionet e nënshkruara do të jenë plotësisht të paguara me para në dorë për në vlerën e tyre nominale;
- c. Zoti Bo Nils Gustav Ryden nga Aalborg, Danimarkë, është emëruar si drejtor i parë menaxhues i shoqërisë dhe Zotërinjtë Lawrence Joseph Ellison, banues në Menlo Park Kaliforni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Robert Joseph Oster, banues në Atherton, Kaliforni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Bernard Joseph Cassidy, banues në Royston, Herts, Angli, dhe Morgens Borge Lindstrom, banues në Aalborg, Danimarkë, janë caktuar si drejtorët e parë mbikëqyrës të shoqërisë;
- d. Viti i parë financiar i shoqërisë do të përfundojë në tridhjetë e një Maj njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë;
- e. Deklarata e miratimit, që i referohet neni 179 e librit 2 të Kodit Civil, siç paraqitet nga Deklarata Ministrore e miratimit nr. B.V. 274. 336 i datës nëntë Korrik i vitit një mijë e nëntë qind e tetëdhjetë e katër të vërtetuar në draftin e këtij akti, që i është aneksuar këtij protokollit;
- f. Shpenzimet e krijimit do t'i mbulojë shoqëria.

Autorizimi që i jepet personit të paraqitur është vërtetuar nga një prokurë private, e cila më vonë, para miratimit të këtij akti, duke qenë i njohur si i vërtetë dhe autentik nga i paraqituri dhe nga unë, noteri, dhe duke dëshmuar sa më sipër është nënshkruar dhe do t'i aneksohet këtij akti.-----

I paraqituri është i njohur për mua, Noterin.-----  
Sipas dokumentit.-----

-----Një kopje e këtij  
Akti është dërguar në Rotterdam në datën e përmendur në fillim të këtij Akti. Pasi  
përmbajtja e këtij akti i është bërë e ditur të paraqiturit prej meje, Noterit, ai ka deklaruar  
se ka marrë dijeni të plotë të përmbajtjes të këtij Akti. Pas kësaj, pasi një pjesë e Aktit i  
është lexuar me zë, i paraqituri e ka nënshkruar dhe po kështu edhe unë, Noteri.

-----u nënshkrua: T.J. Makinen-----

----- Derogee, Noter

#### E LËSHUAR SI KOPJE AUTENTIKE

u nënshkrua më 11 janar 2007:  
Derogee, Noter.

(vula) (nënshkrimi)

(vula)

#### APOSTILLE

Konventa e Hagës 5 tetor 1961

1. Shteti: HOLLANDE

Ky dokument publik

2. Është nënshkruar nga:

J.H.J. Preller

3. Që vepron në cilësinë e noterit

4. Mban vulën/pullën e

Z. J.H.J. Preller në Rotterdam

vërtetuar

5. Në Rotterdam

6. Më 11-01-2007

7. Nga regjistruesi i gjykatës për shkallën e parë  
të Utrechtit

8. Nr. HA RP 07-321

9. Vula/Pulla (vula)

10. Nënshkrimi  
(nënshkrimi)

(pulla)

## **C/M/S Derks Star Busmann**

### **STATUTI EMRI DHE SELIA**

#### **Neni 1**

Emri i Shoqërisë është:

**Oracle Nederland B.V**

Selia qendrore e Shoqërisë është në De Mem.

### **OBJEKTIVAT**

#### **Neni 2**

1. Shoqëria ka si objekt aktiviteti të merret me veprimtari tregtare në fushën e Përpunimit të të dhënave Elektronike, përfshirë këtu tregtimin dhe krijimin e softuerëve dhe të shërbimeve të ngjashme dhe të gjithçkaje në lidhje me këtë fushë.
2. Gjithashtu, Shoqëria ka si qëllim të krijojë, të marrë pjesë në, të bashkëpunojë me, të administrojë dhe financojë shoqëri dhe aktivitete tregtare të tjera.
3. Shoqëria do të autorizohet të sigurojë dhe hipotekojë aktivet si mjet sigurimi për pagesën e borxheve të Shoqërisë ose borxhet e grupit të shoqërive, si dhe të kryejë çdo veprim në lidhje me ose që favorizon veprimet e mësipërme.

### **KAPITALI DHE AKSIONET**

#### **Neni 3**

1. Kapitali i autorizuar i Shoqërisë është në shumën 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) Euro, i ndarë në 20,000 aksione A, me vlerë nominale 450 Euro dhe secili i ndarë në 7,500 aksione B, me vlerë nominale 450 Euro dhe 12,500 aksione C, me vlerë nominale 450 Euro.
2. Në statutin e kësaj Shoqërie kur përmenden aksionet dhe aksionarët nënkuptohen aksionet e të dyja serive dhe përkatësisht zotëruesit e aksioneve të të dyja serive.

### **EMETIMI I AKSIONEVE**

#### **Neni 4**

1. Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve vendos për emetimin e aksioneve dhe gjithashtu vendos edhe për çmimin dhe për kushte të tjera të emetimit. Aksionet nuk mund të emetohen poshtë vlerës nominale.
2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm do të zbatohen sipas së drejtës së nënshkrimit për aksione, por nuk zbatohet për ata individë të cilët gëzojnë të drejtën të nënshkruajnë për aksione.
3. Emetimi i aksioneve pas themelimit të Shoqërisë do të bëhet me vendim të miratuar para një noteri civil që vepron në Hollandë dhe para të cilit janë paraqitur palët.

### **E DREJTA E PARABLERJES**

#### **Neni 5**

1. Me emetimin e aksioneve çdo zotërues i aksioneve të të njëjtës seri ashtu si edhe aksionet që do të emetohen gëzojnë të drejtën e parablerjes në përpjesëtim me shumën e aksioneve të së njëjtës seri që zotërojnë, duke respektuar dhe kufizimet përkatëse ligjore. Nëse një aksionar që gëzon të drejtën e parablerjes së aksioneve dhe nuk e përdor atë pjesërisht ose plotësisht, zotëruesit e tjerë të aksioneve të së njëjtës seri kanë të drejtë të blejnë aksionet e emetuara. Nëse asnjë nga këta aksionarë nuk e përdor pjesërisht ose tërësisht këtë të drejtë, zotëruesit e aksioneve të serive të tjera kanë të drejtën e parablerjes së tyre në përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotërojnë.
2. E drejta e parablerjes mund të kufizohet ose hiqet me vendim të të Asamblesë së Aksionarëve, e cila mbledhet çdo herë për një çështje të vetme.
3. E drejta e parablerjes nuk mund të transferohet
4. Shoqëria njofton me shkrim të gjithë aksionarët në adresën e shënuar nga vetë ata për dhënien e së drejtës së parablerjes dhe kohën në të cilën ajo mund të ushtrohet. E drejta e parablerjes mund të përdoret të paktën deri në 4 javë nga dita e nxjerrjes së njoftimit.
5. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen në varësi të së drejtës së nënshkrimit për aksione. Aksionarët nuk kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve që i janë dhënë një individ që gëzon të drejtën e nënshkrimit për aksionet e marra si më sipër.

## ZOTËRIMI I AKSIONEVE

### Neni 6

1. Në përputhje me dispozitat ligjore dhe me autorizimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, bordi administrativ mund të marrë në emër të Shoqërisë aksione të paguar plotësisht por me vlerë jo më të madhe se gjysma e kapitalit të vendosur.
2. Me autorizimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, bordi administrativ mund të tjetërsojë aksionet që zotëron Shoqëria në kapitalin e saj.

## HUATË PËR NËNSHKRIMIN OSE ZOTËRIMIN E AKSIONEVE

### Neni 7

1. Shoqëria mund të mos japë siguri, të garantojë apo të hyjë dorëzanë në ndonjë mënyrë tjetër ose të angazhohet individualisht ose për më tepër për palë të treta që të nënshkruhet për ose të marrë aksione në kapitalin e saj ose mandatet e depozitimit të tyre në subjekte juridike prej të cilëve varet Shoqëria.
2. Shoqëria mund të ofrojë hua me qëllim nënshkrimin ose zotërimin e aksioneve në kapitalin e saj ose mandatet e depozitimit të tyre deri në masën e rezervave të ndashme. Shoqëria mban një rezervë të pandashme deri në një shumë jo më të madhe se këto hua.

## ZVOGËLIMI I KAPITALIT

### Neni 8

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendos të zvogëlojë kapitalin aksionar duke anuluar aksione ose duke zvogëluar shumën e aksioneve me anë të ndryshimit të Statutit të Shoqërisë. Aksionet për të cilat merret vendimi duhet të përcaktohen shprehimisht në këtë vendim si dhe të vendoset zbatimi i tij. Pjesa e

paguar dhe e anuluar e kapitalit nuk duhet të jetë më e vogël se minimumi i kapitalit të përcaktuar e ligj në kohën e marrjes së vendimit.

2. Anullimi i aksioneve të shlyera dhe të zbritja e shumës së aksioneve të shlyera pjesërisht ose çlirimi nga detyrimi i pagesës mund edhe të bëhet vetëm për sa i përket aksioneve të një serie të caktuar. Pagesa do të përfshijë gjithashtu shpërndarjen e vlerës nominale të aksionit rezervë në fjalë.
3. Dispozitat e nenit 2:208 dhe 2:209 të Kodit Civil do të zbatohen edhe për veprimin e sipër përmendur si dhe për zbatimin e tij.

## **REGJISTRI I AKSIONARËVE**

### **Neni 9**

1. Aksionet do të regjistrohen pasi të jenë numëruar sipas renditjes, aksionet A nga A1, aksionet B nga B1 dhe aksionet C nga C1.
2. Certifikatat e aksioneve mund të mos emetohen.
3. Bordi administrativ mban një regjistër në të cilin shënohen emrat dhe adresat e të gjithë aksionarëve, duke përcaktuar datën e marrjes së aksioneve, datën e pranimit ose paraqitjes dhe shumën e paguar për çdo aksion. Në regjistër do të përfshihet gjithashtu emrat dhe adresat e atyre individëve që kanë të drejtën e uzufuktit ose të drejtën e marrjes peng të aksioneve, duke përcaktuar datën e marrjes së kësaj të drejte, datën e pranimit ose shërbimit.
4. Çdo aksionar, uzufuktari ose pengmarrës duhet të sigurohet që adresa e tyre t'i bëhet e ditur Shoqërisë.
5. Regjistri do të rinovohet rregullisht; në të do të regjistrohet çdo detyrim pagese i pashlyer.
6. Bordi administrativ do të japë falas me kërkesën e një aksionari, uzufuktari apo pengmarrësi pjesë nga regjistri në lidhje me të drejtat e tij mbi aksionet.
7. Bordi administrativ do të dorëzojë regjistrin në zyrat e Shoqërisë për kontroll nga ana e aksionarëve. Informacioni i regjistrin në lidhje me aksionet e papaguara plotësisht nuk do t'i jepet askujt, kopje ose pjesë të këtij informacioni do të jepen vetëm me çmimin e koston.

## **UZUFUKTI DHE E DREJTA E PENGUT MBI AKSIONET MANDATI I DEPOZITIMIT TË AKSIOEVE**

### **Neni 10**

1. Për aksionet mund të krijohet një uzufukt ose peng
2. Uzufuktaret dhe pengmarrësit e aksioneve nuk kanë të drejtë të kërkojnë të drejtën e votës mbi aksionet.
3. Uzufuktaret dhe pengmarrësit nuk gëzojnë të drejtat që ligji i jep zotëruesve të mandatit të depozitimit të aksioneve të emetuara në bashkëpunim me Shoqërinë.
4. Shoqëria nuk është e autorizuar të garantojë bashkëpunimin e saj për emetimin e mandateve të depozitimit të aksioneve.

## **TRANSFERIMI I AKSIONEVE**

### **Neni 11**



1. Aksionet mund të transferohen vetëm me vendim të posaçëm të noterizuar para një noteri publik që vepron në Hollandë, para të cilit individët e përfshirë paraqiten si palë.
2. Shoqëria miraton transferimin e aksioneve me anë të këtij vendimi ose duke dorëzuar një kopje të noterizuar ose pjesë të vendimit, bashkëngjitur këtij dokumenti vendosës edhe një deklaratë e po asaj date.
3. Transferimi i bëhet e ditur Shoqërisë duke i dërguar kopje të noterizuar ose pjesë të vendimit.
4. Nëse Shoqëria është në dijeni për një transferim të aksioneve ajo mund të njohë aktin ligjor si të sajën duke regjistruar marrësin e aksioneve në regjistrin e aksionarëve për atë sa njohja nuk është kërkuar dhe as kalimi nuk është kryer. Shoqëria menjëherë njofton me shkrim palët e përfshira në aktin ligjor duke i dërguar kopje ose pjesë të vendimit. Pas marrjes së tij bëhet një shënim në dokumentin e marrë; data e regjistrimit do të merret edhe si datë e njohjes së vendimit.
5. Transferimi përfshin krijimin, dorëheqjen dhe kalimin e së drejtës së uzufuktit mbi aksionet, krijimin dhe dorëheqjen nga e drejta e pengut mbi aksionet dhe marrjen për llogari të njëres palë.
6. Gjithashtu transferimi quhet i vlefshme ligjërisht edhe në lidhje me Shoqërinë. Përveç rasteve kur vetë Shoqëria është palë e aktit ligjor, të drejtat e aksioneve mund të ushtrohen pas njohjes së aktit ligjor sipas këtij neni ose pasi vendimi të jetë zbatuar, ose pasi të jetë të regjistruar në regjistrin e aksionarëve ashtu siç parashikohet në paragrafin 4.

## KUFIZIME MBI TRANFERIMIN E AKSIONEVE

### Neni 12

1. Aksionet mund të transferohen vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
2. Nëse një aksionar, më poshtë në këtë nen i referuar si “aplikanti”, kërkon të transferojë një ose më shumë aksione, bordi i drejtorëve kërkon miratimin e transferimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, nëse kjo kërkesë nuk miratohet, atëherë vetë aplikanti duhet ta kërkojë këtë gjë.
3. Miratimi do të quhet i vlefshëm nëse:
  - a. kanë kaluar jo më pak se 3 muaj nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim dhe ky vendimi do t'i njoftohet me shkrim aplikantit;
  - b. aplikanti njoftohet me shkrim se cili nga blerësit e mundshëm është të gati të paguajë me para dorë, përveç rasteve kur aplikanti në të njëjtën kohë është njoftuar për refuzimin e kërkesës.
4. Çmimi i blerjes do të përcaktohet nga aplikanti, ndërsa blerësi i mundshëm do të përcaktohet në bashkëpunim me Shoqërinë dhe në rast se kjo gjë nuk arrihet, do të përcaktohet nga një ekspert i pavarur i emëruar nga palët, ose në rast të kundërt do të përcaktohet nga Gjykata Rajonale (Subdistrict) e atij vendi zone ku ndodhet selia e Shoqërisë, me kërkesën e palës më të angazhuar. Aplikanti mund të refuzojë deri brenda një muaji pas njoftimit të çmimit të vendosur.
5. Shoqëria mund të jetë blerëse e mundshme me miratimin e aplikantit.
6. Transferimi bëhet brenda 3 muajve pas marrjes së miratimit.

7. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen nëse aksionari është i detyruar ligjërisht t'i transferojë aksionet e tij një aksionari tjetër.
8. Bordi i drejtorëve administrativ, të paktën në herë në vit, duhet t'i sigurojë bordit të drejtorëve të mbikëqytjes të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij.

## **BORDI I DREJTORËVE DHE BORDI MBIKËQYRËS**

### Neni 13

1. Shoqëria administrohet nga një bord i drejtorëve i përbërë nga një ose më shumë drejtorë të mbikëqyrur nga bordi mbikëqyrës i cili përbëhet nga të paktën 3 anëtarë. Nëse ka më pak se 3 drejtorë mbikëqyrës, bordi duhet të marrë menjëherë masa për plotësimin e numrit të anëtarëve të tij.
2. Bordi i drejtorëve cakton detyrat e tij duke u këshilluar me bordin mbikëqyrës. Me miratimin e bordit mbikëqyrës, bordi i drejtorëve mund të hartojë rregullore me anë të të cilave rregullohen çështjet e brendshme të bordit administrativ.
3. Bordi i drejtorëve mund të marrë vendime në dhe jashtë mbledhjeve. Vendimet jashtë mbledhjeve mund të merren vetëm nëse të gjithë drejtorët kanë mundur të gjykojnë çështjen në fjalë.
4. Bordi i drejtorëve vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.
5. Pa çënuar dispozitat e tjera të këtij neni të Statutit të Shoqërisë, bordi i drejtorëve kërkon miratimin e bordit mbikëqyrës për çështjet e mëposhtme:
  - a. për emetimin dhe marrjen e aksioneve në shkëmbim të detyrimeve të Shoqërisë ose në shkëmbim të detyrimeve të një ortakërie të pjeshme ose të një shoqërie tjetër me të cilën Shoqëria ka partneritet të plotë;
  - b. bashkëpunimin për çështje të regjistrimit të mandateve të depozitimit të aksioneve;
  - c. aplikim për listim ose tërheqje të listimit të detyrimeve të parashikuara në paragrafin a dhe mandatet e depozitimit të parashikuar në paragrafin b në listën zyrtare të çdo burse;
  - d. të lidhë ose të shkëputet nga bashkëpunime të qëndrueshme të Shoqërisë ose të një dege të shoqërisë me një subjekt juridik ose shoqëri tjetër ose si ortak me përgjegjësi të plota në një partneritet të kufizuar ose shoqëri partnere, në rast se ky bashkëpunim ose shkëputje ka një rëndësi të madhe për Shoqërinë;
  - e. të ketë të drejtën e pjesëmarrjes në shumën sa të paktën  $\frac{1}{4}$  e kapitalit të deklaruar me rezervat sipas bilancit të Shoqërisë të shoqëruar me shënime shpjeguese, ose pjesëmarrjen e një dege të shoqërisë në kapitalin e një shoqërie tjetër dhe rritjen ose zvogëlimin drastik të kësaj pjesëmarrjeje;
  - f. investimet që kërkojnë një shumë të barabartë me të paktën  $\frac{1}{4}$  e kapitalit të deklaruar me rezervat e Shoqërisë sipas bilancit të saj;
  - g. propozim për ndryshimin e Statutit;
  - h. propozim për prishjen e Shoqërisë;
  - i. depozitimin në rast falimentimi dhe aplikimin për shtyrje të afatit të pagesës;
  - j. zgjidhjen e kontratës së punës në të njëjtën kohë ose brenda një kohe të shkurtër të një numri të konsiderueshëm punonjësish të Shoqërisë ose të një dege;

- k. ndryshimin drastik të kushteve të punës të një numri të konsiderueshëm punonjësish të Shoqërisë ose të degëve;
  - l. propozim për zvogëlimin e kapitalit të emetuar.
6. Bordi i drejtorëve kërkon për më tepër, miratimin e bordit mbikëqyrës në lidhje me vendimet për çështje të cilat Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka vendosur që vendimet e bordit të drejtorëve në lidhje me këto çështje duhet t'i nënshtrohen miratimit të bordit mbikëqyrës.
  7. Mungesa e miratimit për vendime të parashikuara në paragrafin e mësipërm nuk ndikojnë në autoritetin e bordit të drejtorëve ose drejtorëve.
  8. Bordi mbikëqyrës jep udhëzime për mbarëvajtjen e përgjithshme të politikave financiare, sociale, ekonomike dhe të personelit që duhen ndjekur.
  9. Në rast mungese ose paaftësie për pjesëmarrjen e të gjithë drejtorëve administrativ dhe përkatësisht drejtorit të vetëm, administrimi do t'i besohet përkohësisht bordit mbikëqyrës, në rast se Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk ka emëruar një individ të posaçëm për këtë qëllim. Nëse bordi mbikëqyrës drejton përkohësisht administrimin e Shoqërisë, ai mund t'ia kalojë këtë detyrë një ose më shumë individëve nga ose jashtë anëtarëve të tij.

## **PËRFAQËSIMI**

### **Neni 14**

1. Bordi i drejtorëve përfaqëson Shoqërinë. Gjithashtu, çdo drejtor veçmas autorizohet të përfaqësojë Shoqërinë.
2. Nëse një ose më shumë drejtorë hyjnë në marrëveshje private me Shoqërinë ose ndërmarrin privatisht veprime kundër Shoqërisë, atëherë Shoqëria përfaqësohet nga drejtori mbikëqyrës i emëruar nga bordi mbikëqyrës për këtë qëllim, përveç rasteve kur Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka emëruar një ose më shumë individë për këtë detyrë; gjithashtu mund të emërohet edhe drejtori prej të cilit ka lindur ky konflikt interesash. Nëse një ose më shumë drejtorë kanë konflikt interesash me interesat e Shoqërisë në një mënyrë tjetër ndryshe nga ajo e përcaktuar në fjalinë e parë të këtij paragrafi, drejtorët dhe bordi mbikëqyrës nuk e humbasin të drejtën e përfaqësimit.

## **EMËRIMI, PEZULLIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORËVE ADMINISTRATIV**

### **Neni 15**

1. Drejtorët administrativ emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, e cila gjithashtu përcakton edhe numrin e tyre.
2. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka të drejtë të pezullojë drejtorët administrativ në çdo kohë.
3. Bordi mbikëqyrës ka gjithashtu të drejtë të pezullojë drejtorët administrativ në çdo kohë.

Në rast se pezullimi nuk kryhet paraprakisht, do të mbahet një mbledhje e zakonshme e aksionarëve brenda një muaji gjatë së cilës do të shqyrtohet pezullimi. Mosmbajtja e kësaj mbledhjeje do të shkaktojë rrezimin e pezullimit.

Nëse në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve nuk arrihet pezullimi ose shkarkimi i drejtorit administrativ, pezullimi rrezohet.

Vendimi për pezullim mund të merret vetëm një herë dhe mund të merret brenda një periudhe tre mujore, dhe hyn në fuqi nga data e marrjes së vendimit në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve.

## EMËRIMI, PEZULLIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORËVE MBIKËQYRËS

### Neni 16

1. Drejtorë mbikëqyrës nuk mund të jenë:
  - a. Persona të punësuar nga shoqëria;
  - b. personat e punësuar nga një shoqëri vartëse;
  - c. administratorët dhe personat e punësuar nga një organizatë punësimi e cila zakonisht merret me vendosjen e kushteve të punësimit të personave që përmenden në pikat a dhe b.
2. Duke i qëndruar dispozitave në paragrafin 5, drejtorët mbikëqyrës do të emërohen nga bordi i drejtorëve në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve, për aq sa emërimi nuk është bërë më parë me aktin e themelimit ose përpara se ky nen të zbatohet nga shoqëria. Emërimi duhet të jetë i arsyetueshëm.
3. Bordi i drejtorëve mbikëqyrës përpilon një skicë të detajuar për përbërjen dhe numrin e tyre, duke patur parasysh llojin e shoqërisë, veprimtarinë e saj, ekspertizën dhe formimin e drejtorëve mbikëqyrës. Bordi i drejtorëve mbikëqyrës do të diskutojë skicën e detajuar në takimin e parë dhe më pas në mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve do të diskutojë për ndryshimet e tij.
4. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve dhe këshilli i punës mund të rekomandojë individë bordit mbikëqyrës për tu emëruar si drejtor mbikëqyrës. Bordi mbikëqyrës do të njoftojë ata nëse do të ketë nevojë për plotësime të vendeve vakante. Në rast se për vendin vakant aplikohet e drejta e rekomandimit sipas paragrafit 5, bordi mbikëqyrës gjithashtu duhet ta bëjë këtë të ditur. Bordi mbikëqyrës do të njoftojë për emërimin njëherazi në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve dhe pranë këshillit të punës.
5. Zbatohet tek një e treta e numrit të anëtarëve të bordit mbikëqyrës se bordi mbikëqyrës vendos një person të rekomanduar nga këshilli I punës për emërimin, vetëm nëse bordi mbikëqyrës kundërshton rekomandimin në bazë të parashikimeve se personi i rekomanduar nuk arrin të kryejë detyrën e drejtorit mbikëqyrës ose nëse bordi mbikëqyrës funksionon sic duhet me metodë rekomandimeve. Nëse numri i anëtarëve të bordit mbikëqyrës nuk ndahet në tre, numri më i pakët i nevojshëm që mund të ndahet nga tre mund të merret në konsideratë për përcaktimin e numrit të anëtarëve për të cilët zbatohet e drejta e rekomandimit.
6. Nëse bordi mbikëqyrës kundërshton, ai njofton këshillin e punës duke përcaktuar edhe arsyet. Bordi mbikëqyrës menjëherë duhet të këshillohet me këshillin e punës për të arritur një marrëveshje për emërimin.
7. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të refuzojë emërimin me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të cilët duhet të përfaqësojnë të paktën 1/3 e kapitalit të deklaruar. Nëse të paktën 1/3 e kapitalit të deklaruar nuk është e përfaqësuar në mbledhje, atëherë duhet të mbahet një mbledhje tjetër ku emërimi mund të refuzohet me shumicë absolute të votave. Bordi mbikëqyrës duhet të propozojë një emërim të ri. Paragrafët nga 4 deri te 6 do të zbatohen sipas rastit.

Nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk emëron individin e propozuar dhe as nuk vendos të refuzojë emërimin, bordi mbikëqyrës vendos të emërojë individin e propozuar.

8. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund t'i kalojë autoritetin e dhënë sipas paragrafit 4, një këshilli aksionarësh, anëtarët e të cilit përcaktohen nga Asambleja, për një afat që përcaktohet nga vetë Asambleja dhe çdo mandat maksimumi deri në 2 vjet; në rast të tillë bordi mbikëqyrës njofton këshillin sipas paragrafit 4. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mundet në çdo kohë të anullopjë kalimin e kompetencave.
9. Për miratimin e këtij neni këshilli i punës do të jetë i vetmi që nënkuptohet sipas konceptit të parashikuar në nenin 2:268, paragrafi 11 i Kodit Civil.
10. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund ta humbasë besimin e saj nga bordi mbikëqyrës me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm që përfaqësojnë të paktën 1/3 të kapitalit të deklaruar. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar. Vendimi nuk mund të merret në lidhje me drejtorët mbikëqyrës të emëruar sipas paragrafit në lidhje me shoqëritë të nenit 2:271 të Kodit Civil.
11. Ky vendim do të merret vetëm pasi bordi të njoftojë Këshillin e Punës për propozimin e bërë si dhe për arsyet e tij.
12. Njoftimi do të bëhet të paktën 30 ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme ku do të diskutohet ky propozim. Nëse Këshilli i punës merr një vendim, bordi njofton bordin mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme për këtë gjë. Këshilli i punës duhet të shpjegojë pikëpamjet e tij në Asamble.
13. Vendimi çon në shkarkimin e menjëhershëm të anëtarëve të bordit mbikëqyrës. Atëherë bordi mund t'i kërkojë Gjykatës së Apelit të Shoqërive Tregtare në Amsterdam të emërojë një ose më shumë drejtorë mbikëqyrës.
14. Bordi mbikëqyrës, gjithashtu është i autorizuar të pezullojë drejtorët administrativ në çdo kohë. Nëse pezullimi nuk anullopët më parë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mblidhet brenda një muaji për të anullopët pezullimin. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk vendos as të vazhdojë pezullimin dhe as vendos për shkarkimin, pezullimi anullopët. Vendimi për vazhdimin e pezullimit mund të merret vetëm një herë dhe periudha e pezullimit mund të zgjasë jo më shumë se 3 muaj, duke nisur që nga data e marrjes së këtij vendimi nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.
15. Nëse një drejtor mbikëqyrës ka qenë në detyrë për një periudhë 4 vjeçare qysh nga emërimi i tij i fundit, ai mund të japë dorëheqjen jo më vonë se ditën e mbledhjes së radhës së Asamblesë pas mbarimit të mandatit të tij 4 vjeçar ose një ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
16. Bordi mbikëqyrës, në çdo kohë mund të autorizohet të hartojë një listë për dorëheqjen.

## **SHPËRBLIMI I DREJTORËVE ADMINISTRATIVË DHE MBIKËQYRËS**

### **Neni 17**

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendos për çdo drejtor administrativ në veçanti pagën e tij si dhe kushte të tjera të punësimit.
2. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve cakton për çdo drejtor mbikëqyrës pagën e tij.

## BORDI MBIKËQYRËS

### Neni 18

1. Bordi mbikëqyrës ka për detyrë të mbikëqyrë politikën e bordit administrativ si dhe ecurinë e përgjithshme të çështjeve të Shoqërisë dhe veprimtarive tregtare të lidhura me të. Ai këshillon bordin administrativ. Gjatë kryerjes së detyrave drejtorët mbikëqyrës veprojnë në përputhje me interesat e Shoqërisë si dhe veprimtarive të lidhura me të.
2. Bordi mbikëqyrës zgjedh nga anëtarët e tij kryetarin dhe nga ose jo prej anëtarëve të tij një sekretar. Nëse kryetari nuk është i pranishëm në një mbledhje, bordi zgjedh kryetarin e mbledhjes.
3. Bordi mbikëqyrës mblidhet sa herë një drejtor mbikëqyrës e quan të nevojshme. Drejtorët administrativ janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e bordit mbikëqyrës nëse ju kërkohet si dhe të japin të gjithë informacionin e kërkuar.
4. Bordi mbikëqyrës merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.
5. Bordi mbikëqyrës mirato vendime të vlefshme vetëm nëse shumica e anëtarëve të bordit janë të pranishëm ose të përfaqësuar në takim.
6. Bordi mbikëqyrës mund të marrë vendime jashtë zyre, me anë të telegrafit, teleteksit, telefaksit ose me mënyra të tjera komunikimi, nëse bëhen me shkrim dhe nëse të gjithë drejtorët mbikëqyrës janë pro propozimit në fjalë.
7. Bordi mbikëqyrës është i autorizuar të kontrollojë regjistrat, protokollet si dhe të dokumente të tjera Shoqërisë. Bordi administrativ pajis bordin mbikëqyrës me të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
8. Drejtorët administrativ të paktën një herë në vit i ofrojnë drejtorëve mbikëqyrës të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre.

## INDIVIDËT E AUTORIZUAR ME PROKURË

### Neni 19

Bordi administrativ pajis me prokurë një ose më shumë individë të autorizuar për një funksion të caktuar.

## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

### Neni 20

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mblidhet të paktën një herë në vit. Brenda 6 muajsh pas përfundimit të vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme miraton llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimit dhe diskuton raportin vjetor dhe nëse kërkohet me ligj hartohet një raport vjetor, përveç rastit kur periudha për hartimin e llogarive vjetore është zgjatur me vendim të Asamblesë sipas nenit 27, paragrafi 2.
2. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen në selinë e Shoqërisë. Në se një takim zhvillohet në një vend tjetër, mund të merren vendime të vlefshme vetëm nëse i gjithë kapitali i deklaruar është i pranishëm.

### Neni 21

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet nëse kërkohet nga bordi administrativ, bordi mbikëqyrës, nga vetë Asambleja ose në rast se një ose më shumë aksionarë së

bashku që përfaqësojnë të paktën 1/10 e kapitalit të deklaruar, të cilët njoftojë me shkrim bordin administrativ dhe mbikëqyrës duke përcaktuar qartë çështjen që duan të diskutojnë.

2. Çështja e shtruar për diskutim e kërkuar me shkrim nga një ose më shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën 1/100 e kapitalit aksionar, do të përmendet në njoftimin e mbledhjes nëse Shoqëria e ka marrë këtë njoftim jo më vonë se trembëdhjetë ditë para zhvillimit të mbledhjes, përveç rasteve kur nuk përputhet me interesat kryesore të Shoqërisë.
3. Nëse as bordi i drejtorëve, as bordi mbikëqyrës dhe as Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve, të cilat kanë kompetenca të barabarta, nuk arrijnë të përmbushin kërkesën për mbledhjen e Asamblesë brenda 6 javëve pas njoftimit të kërkesës, aplikanti ose aplikantët mund ta kërkojnë vetë këtë gjë.

#### Neni 22


1. Pa çenuar dispozitat e paragrafit 3 të nenit të mësipërm, aksionarët mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë të thirrur nga ose në emër të bordit administrativ, mbikëqyrës ose Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.
2. Njoftimi i mbledhjes bëhet jo më vonë se 15 ditë para mbledhjes. Aksionarët njoftohen me shkrim në adresat e dhëna nga vetë ata. Nëse dispozitat e këtij neni nuk përmbushen, sidoqoftë vendimet quhen të vlefshëm nëse i gjithë kapitali i deklaruar është i pranishëm ose i përfaqësuar në votim.
3. Tema për diskutim duhet të përcaktohet në letërën e njoftimit. Në rast propozimi për zvogëlimin e kapitalit, në njoftim duhet të përcaktohet qëllimi i zvogëlimit të kapitalit dhe mënyra e zbatimit. Megjithatë, vendimet për çështje të cilat nuk janë përcaktuar në njoftimin e mbledhjes apo në një letër plotësuese brenda afatit të përcaktuar para datës së mbledhjes, nuk mund të diskutohen, edhe nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm në mbledhje.

#### Neni 23

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve drejtohet nga një kryetar i zgjedhur nga vetë Asambleja.
2. Drejtorët administrativ dhe drejtorët mbikëqyrës kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe si të tillë kanë të drejtën e votës këshilluese.
3. Nëse nuk mbahet raport noterial për takimin, sekretari i përcaktuar nga kryetari mban procesverbalin e takimit, i cili do të miratohet dhe nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari. I njëjti individ mund të jetë njëherazi kryetar dhe sekretar.
4. Kryetari si dhe çdo drejtor administrativ dhe mbikëqyrës mund të kërkojnë në çdo kohë të mbahet një raport zyrtar i takimit për shpenzimet e Shoqërisë.
5. Nëse mbahet një raport noterial për diskutimet e takimit, nënshkrimi i tij nga kryetari mund të mjaftojë.

#### Neni 24

1. Çdo aksionar ka të drejtën e një vote, pavarësisht nëse aksionari zotëron një ose disa seri aksionesh.
2. Të gjitha vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

- 
3. Për të përcaktuar numrin e aksionarëve që do të votojnë, qoftë të pranishëm ose të përfaqësuar, aksionet për të cilët ligji përcakton se nuk kanë të drejtë vote nuk do të merren parasysh.
  4. Në rast se votat janë të barabarta, atëherë vendos shoqëria "Oracle Technology", shoqëri e cila vepron sipas ligjeve të Irlandës, e regjistruar në Dublin, Irlandë 1,2 Harbourmaster Place, Custom House Dock.

#### Neni 25

1. Aksionarët mund të marrin vendime edhe pa mbledhje.
2. Vendimet pa mbledhje mund të merren vetëm nëse miratohen unanimitisht dhe votimi do të bëhet me shkrim ose me telegraf, teleteks, telefaks apo edhe me mënyra të tjera komunikimi.

#### TAKIMET E ZOTËRUESVE TË AKSIONEVE TË NJË SERIE TË ÇAKTUAR.

#### Neni 26

1. Takimet e zotëruesve të aksioneve të një serie të çaktuar mund të mbahen nëse kërkohet miratimi i një vendimi nga ky takim. Një takim i tillë mund të mbahet sa herë të konsiderohet i nevojshëm nga bordi administrativ ose nga një ose më shumë zotërues të aksioneve të së njëjtës serie, të cilët së bashku përfaqësojnë të paktën 1/5 e kapitalit të aksioneve të asaj serie.
2. Nëse një ose më shumë zotërues aksionesh të një serie të çaktuar sipas paragrafit 1 kërkojnë mbajtjen e një takimi të aksionarëve të po asaj serie, ata duhet të njoftojnë me shkrim bordin administrativ. Nëse në këtë rast bordi administrativ nuk përmbush kërkesën në mënyrë që mbledhja të zhvillohet brenda 10 ditësh pas kërkesës, aplikanti ose aplikantët mund të mbledh vetë.
3. Nenet nga 22 deri në 25 do të zbatohen sipas rastit për vendimet që do të merret nga aksionarët e një serie të çaktuar, nëse mbledhja është njoftuar jo më vonë se 6 ditë para.

#### VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE DHE PUBLIKIMI I TYRE

#### Neni 27

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Qershor deri në dhe duke përfshirë ditën e 31 të Majit.
2. Brenda 5 muajve pas përfundimit të vitit financiar të Shoqërisë, përveç rasteve kur kjo periudhë zgjatet jo për më shumë se 6 muaj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në situata të veçanta, bordi administrativ harton një herë në vit llogaritë vjetore të cilat do të lihen në zyrat e Shoqërisë për tu kontrolluar nga aksionarët. Llogaritë vjetore do të shoqërohen edhe nga deklaratat e llogaritit sipas paragrafit 5 ku parashikohet kjo gjë, ose nëse kërkohet me ligj si dhe nga të dhëna të tjera të përmendur në nenin 2:392. paragrafi 1 i Kodit civil, nëse dispozitat e këtij paragrafi zbatohen për Shoqërinë.
3. Llogaritë vjetore do të nënshkruhen nga të gjithë drejtorët administrativ dhe mbikëqyrës; nëse nënshkrimi i njërit prej tyre mungon, arsyet do të përcaktohen në raport.
4. Shoqëria duhet të sigurojë që llogaritë vjetore dhe raporti vjetor nëse kërkohet me ligj hartimi i tij si dhe të dhëna të tjera të parashikuara në paragrafin 2, të jenë në



zyra e saj për inspektim qysh nga dita e njoftimit të mbledhjes ku do të shqyrtohet kjo gjë.

5. Nëse kërkohet me ligj, Shoqëria duhet të emërojë një llogaritar, sic parashikohet në nenin 2:393 të Kodit Civil, për të bërë kontrollin e llogarive vjetore në përputhje me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni. Llogaritari raporton mbi kontrollin e tij bordin administrativ dhe do të nxjerrë rezultatet në një deklaratë në sipas llogarive vjetore.
6. Miratimi i llogarive vjetore nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ??? e drejtorëve administrativ për administrimin e tyre dhe drejtorëve mbikëqyrës për mbikëqyrjen e vitit të mëparshëm financiar, nëse në takim bëhen vërejtje. Nëse sipas paragrafit 5, Shoqëria ka autorizuar një llogaritar të kontrollojë llogaritë vjetore dhe Asambleja e Përgjithshme nuk ka mundur të njihet me këtë deklaratë të llogaritarit, nuk mund të miratohen llogaritë vjetore, përveç rasteve kur sipas dispozitave të paragrafit 2, përcaktohet arsyeja e mungesës së kësaj deklarate.
7. Shoqëria siguron publikimin në kohë të llogarive dhe raportit vjetor dhe nëse kërkohet me ligj hartohet raporti vjetor dhe të dhënat e përcaktuara në paragrafin 2 publikohen.

## FITIMI DHE SHPËRNDARJA E TIJ

### Neni 28

1. Fitimi nënkupton diferencën ndërmjet fitimit dhe humbjeve të miratuara.
2. Shoqëria shpërndan fitimin ndërmjet aksionarëve nëse ai është më i madh se pjesa e paguar dhe e mbajtur për rezervat e cila duhet mbajtur sipas ligjit.
3. Shpërndarja e fitimit mund të bëhet vetëm pas miratimit të llogarive vjetore nga të cilat ai duhet të rezultojë.
4. Fitimi do të merret në Asamble. Shpërndarja e fitimit bëhet në përpjesëtim me vlerën nominale të shtuar me vlerën e aksioneve rezervë që ato kanë.
5. Shoqëria mund të bëjë shpërndarjen e fitimit nëse kërkesat e paragrafit 2 janë përmbushur.
6. Gjatë llogaritjeve të ndarjes së fitimit të aksioneve që Shoqëria zotëron në kapitalin e saj nuk përlllogarit edhe ato aksione për të cilat është krijuar një uzufukt në emër të të tjerëve dhe jo të Shoqërisë.
7. Deficitet e detyrimeve të parashikuara ligjërisht do të paguhen nga rezervat për aq sa e lejon ligji.

## VLERA E AKSIONEVE REZERVË

### Neni 29

1. Nëse aksionet paguhen me vlerën e tyre, duhet të mbahet një rezervë sa vlera e aksionit, rezervë e cila do të shpërndahet zotëruesve të aksioneve në përpjesëtim me vlerën nominale të aksioneve për të cilët është bërë kjo pagesë.
2. Pagesa e aksioneve mund të bëhet vetëm për aksionet e seria A, Serisë B, ose C.
3. Zotëruesit e aksioneve për të cilët është paguar vlera nominale, në çdo kohë kanë të drejtë, që me anë të një vendimi që duhet të merret nga vetë ata, të marrin tërësisht ose pjesërisht vlerën e aksionit rezervë; për këtë gjë nuk nevojitet vendim nga Asambleja.

## NDRYSHIMI I STATUTIT DHE PRISHJA E SHOQËRISË

### Neni 30

Nëse, në Asamblenë e Përgjithshme, propozohet ndryshimi i statutit të Shoqërisë, individët të cilët kërkuan takimin e Asamblesë duhet që njëherazi me njoftimin e mbledhjes, të dorëzojnë në zyrat e Shoqërisë një kopje të propozimit ku ndryshimi propozuar të jetë i përfshirë, për inspektim nga çdo aksionar deri në fundin e takimit.

Nëse kjo gjë nuk arrihet, miratimi i propozimit mund të vendoset nëse miratohet unanimisht një takim ku i gjithë kapitali është i pranishëm ose i përfaqësuar. Aksionarëve duhet t'ju jepet falas para datës së mbledhjes një kopje e propozimit.

### Neni 31

1. Nëse Shoqëria shpërbëhet me anë të një vendimi të marrë në Asamble, ajo do të likuïdohet nga drejtorët administrativ, përveç rasteve kur Asambleja vendos ndryshe.
2. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendos numrin e likuiduesve.

### Neni 32

Nga bilanci i kapitalit të Shoqërisë së shpërbërë që rezulton pas pagimit të debitorëve, nëse është e mundur, vlera nominale e aksioneve B plus vlerën e aksioneve rezervë që i korrespondojnë do të shpërndahen në përpjesëtim me vlerën e përbashkët të aksioneve B që zotëron aksionari. Nëse, gjatë kohës që këto aksione janë vendosur, dividendi i shpërndarë në total për aksionet B është më pak se 4% në vit, i llogaritur për çdo vit mbi vlerën nominale dhe çmimin e aksionit, kjo shumë do të shpërndahet aksionarëve të aksioneve B si e barabartë me këtë diferencë.

51% e bilancit aktiveve të mbetura nga Shoqëria e shpërbërë do të shpërndahen në përpjestim me shumën e aksioneve B që zotëron aksionari. Pjesa e mbetur do t'i shpërndahet aksionarëve të aksioneve përkatësisht A dhe C në përpjesëtim me shumën e aksioneve A dhe C që zotërojnë. Në rast se nuk është emetuar asnjë aksion A ose C, bilanci do t'i paguhet aksionarëve të aksioneve B në përpjestim me shumën e aksioneve B që zotëron.

## NENI PËRFUNDIMTAR

### Neni 33

Të gjitha kompetencat që nuk i janë caktuar bordit administrativ, mbikëqyrës i kalojnë Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve brenda kufijve të vendosur me ligj dhe sipas këtij Statuti.

**AKTI I NDRYSHIMIT TË STATUTIT**  
**të: Oracle Nederland B.V,**

Sot, më 5 Nëntor Dy mijë e katër, përpara meje, Jan Willem Anton Schenk, noter civil në Utrecht (Hollandë)u paraqit personi i mëposhtëm: Robert Hendrikus Martinus van Zijl, lindur në Utrecht (Hollandë) më 8 Nëntor 1979, me seli në adresën (3584 BB) Utrecht (Hollandë), Pythagoraslaan 2.

Individi i paraqitur deklaron:

- A. Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar: **Oracle Nederland B.V.**, me seli në De Meern (Hollandë), me adresë kryesore të aktivitetit në (3454 PV) De Mem (Hollandë), Zijnzathe 6, e regjistruar në regjistrin tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Utrecht me dosje Nr. 30096087, më poshtë referuar si: "Shoqëria", është themeluar me njëzetë e tetë Gusht njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër.  
Statuti i shoqërisë wshtw ndryshuar më njëzet e katër Dhjetor dymijë e një sipas aktit të nënshkruar para J.W.A. Schenk, noter civil që ushtron profesionin e tij në Utrecht (Hollandë) dhe nuk është ndryshuar më qysh atëherë.
- B. Më 8 Tetor 2004, aksionerët e vetëm të Shoqërisë, në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore dhe të statutit, me votë unanime dhe pa mbajtur një takim, vendosën të ndryshojnë tërësisht statutin e Shoqërisë.  
Me anë të këtij vendimi, individi i paraqitur para meje, ishte i autorizuar të nënshkruante aktin e ndryshimit të Statutit të Shoqërisë.
- C. Vendimi dhe autorizimi ishin miratuar me një vendim të aksionarëve i cili ishte bashkëngjitur këtij vendimi.
- D. Miratimi i Ministrisë për ndryshimin e statutit të Shoqërisë, siç kërkohet me ligj, është dhënë nga Ministri i Drejtësisë së Hollandës më 3 Nëntor 2004, me numër B.V. 274336, miratim i cili jepet me anë të një çertifikate e cila i është bashkëngjitur këtij akti.

Sipas vendimit të sipërpërmendur, statuti i Shoqërisë u ndryshua dhe u hartua sërisht. Pas këtij ndryshimi statuti vijon si më poshtë:

**"EMRI DHE SELIA**

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **Oracle Nederland B.V**

Selia qendrore e Shoqërisë është në De Mem.

**OBJEKTIVAT**

Neni 2

1. Shoqëria ka si objekt aktiviteti të merret me veprimtari tregtare në fushën e Përpunimit të të dhënave Elektronike, përfshirë këtu tregtimin dhe krijimin e

softuerëve dhe të shërbimeve të ngjashme dhe të gjithckaje në lidhje me këtë fushë.

2. Gjithashtu, Shoqëria ka si qëllim të krijojë, të marrë pjesë në, të bashkëpunojë me, të administrojë dhe financojë shoqëri dhe aktivitete tregtare të tjera.
3. Shoqëria do të autorizohet të sigurojë dhe hipotekojë aktivet si mjet sigurimi për pagesën e borxheve të Shoqërisë ose borxhet e grupit të shoqërive, si dhe të kryejë çdo veprim në lidhje me ose që favorizon veprimet e mësipërme.

## KAPITALI DHE AKSIONET

### Neni 3

1. Kapitali i autorizuar i Shoqërisë është në shumën 18,000,000 (tetëmbëdhjetë million) Euro, i ndarë në 20,000 aksione A, me vlerë nominale 450 Euro dhe secili i ndarë në 7,500 aksione B me vlerë nominale 450 Euro dhe 12,500 aksione C, me vlerë nominale 450 Euro.
2. Në statutin e kësaj Shoqërie kur përmenden aksionet dhe aksionarët nënkuptohen aksionet e të dyja serive dhe përkatësisht zotëruesit e aksioneve të të dyja serive.

## EMETIMI I AKSIONEVE

### Neni 4

1. Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve vendos për emetimin e aksioneve dhe gjithashtu vendos edhe për çmimin dhe për kushte të tjera të emetimit. Aksionet nuk mund të emetohen poshtë vlerës nominale.
2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm do të zbatohen sipas së drejtës së nënshkrimit për aksione, por nuk zbatohet për ata individë të cilët gëzojnë të drejtën të nënshkruajnë për aksione.
3. Emetimi i aksioneve pas themelimit të Shoqërisë do të bëhet me vendim të miratuar para një noteri civil që vepron në Hollandë dhe para të cilit janë paraqitur palët.

## E DREJTA E PARABLERJES

### Neni 5

1. Me emetimin e aksioneve çdo zotërues i aksioneve të të njëjtës seri ashtu si edhe aksionet që do të emetohen gëzojnë të drejtën e parablerjes në përpjestim me shumën e aksioneve të së njëjtës seri që zotërojnë, duke respektuar dhe kufizimet përkatëse ligjore. Nëse një aksionar që gëzon të drejtën e parablerjes së aksioneve dhe nuk e përdor atë pjesërisht ose plotësisht, zotëruesit e tjerë të aksioneve të së njëjtës seri kanë të drejtë të blejnë aksionet e emtuara. Nëse asnjë nga këta aksionarë nuk e përdor pjesërisht ose tërësisht këtë të drejtë, zotëruesit e aksioneve të serive të tjera kanë të drejtën e parablerjes së tyre në përpjestim me numrin e aksioneve që zotërojnë.
2. E drejta e para blerjes mund të kufizohet ose hiqet me vendim të të Asamblesë së Aksionarëve, e cila mbidhet çdo herë për një çështje të vetme.
3. E drejta e parablerejs nuk mund të transferohet
4. Shoqëria njofton me shkrim të gjithë aksionarët në adresën e shënuar nga vetë ata për dhënien e së drejtës së parablerjes dhe kohën në të cilë ajo mund të ushtrohet. E drejta e parablerjes mund të përdoret të paktën deri në 4 javë nga dita e nxjerrjes së njoftimit.

5. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen në varësi të së drejtës së nënshkrimit për aksione. Aksionarët nuk kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve që i janë dhënë një individit që gëzon të drejtën e nënshkrimit për aksionet e marra si më sipër.

## ZOTËRIMI I AKSIONEVE

### Neni 6

1. Në përputhje me dispozitat ligjore dhe me autorizimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, bordi administrativ mund të marrë në emër të Shoqërisë aksione të paguar plotësisht por me vlerë jo më të madhe se gjysma e kapitalit të vendosur.
2. Me autorizimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, bordi administrativ mund të tjetërsojë aksionet që zotëron Shoqëria në kapitalin e saj.

## HUATË PËR NËNSHKRIMIN OSE ZOTËRIMIN E AKSIONEVE

### Neni 7

1. Shoqëria mund të mos japë siguri, të garantojë apo të hyjë dorëzanë në ndonjë mënyrë tjetër ose të angazhohet individualisht ose për më tepër për palë të treta që të nënshkruhet për ose të marrë aksione në kapitalin e saj ose madatet e depozitimit të tyre në subjekte juridike prej të cilëve varet Shoqëria.
2. Shoqëria mund të ofrojë hua me qëllim nënshkrimit ose zotërimit të aksioneve në kapitalin e saj ose mandatat e depozitimit të tyre deri në masën e rezerveve të ndashme. Shoqëria mban një rezervë të pandashme deri në një shumë jo më të madhe se këto hua.

## ZVOGËLIMI I KAPITALIT

### Neni 8

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendos të zvogëlojë kapitalin aksionar duke anuluar aksione ose duke zvogëluar shumën e aksioneve me anë të ndryshimit të Statutit të Shoqërisë. Aksionet për të cilat merret vendimi duhet të përcaktohen shprehimisht në këtë vendim si dhe të vendoset zbatimi i tij. Pjesa e paguar dhe e anuluar e kapitalit nuk duhet të jetë më e vogël se minimumi i kapitalit të përcaktuar e ligj në kohën e marrjes së vendimit.
2. Anullimi i aksioneve të shlyera dhe të zbritja e shumës së aksioneve të shlyera pjesërisht ose çlirimi nga detyrimi i pagesës mund edhe të bëhet vetëm për sa i përket aksioneve të një serie të caktuar. Pagesa do të përfshijë gjithashtu shpërndarjen e vlerës nominale të aksionit rezervë në fjalë.
3. Dispozitat e nenit 2:208 dhe 2:209 të Kodit Civil do të zbatohen edhe për venrimin e sipër përmendur si dhe për zbatimin e tij.

## REGJISTRI I AKSIONARËVE

### Neni 9

1. Aksionet do të regjistrohen pasi të jenë numëruar sipas renditjes, aksionet A nga A1, aksionet B nga B1 dhe aksionet C nga C1.
2. Certifikatat e aksioneve mund të mos emetohen.
3. Bordi administrativ mban një regjistër në të cilin shënohen emrat dhe adresat e të gjithë aksionarëve, duke përcaktuar datën e marrjes së aksioneve, datën e pranimit

ose paraqitjes dhe shumën e paguar për çdo aksion. Në regjistër do të përfshihet gjithashtu emrat dhe adresat e atyre individëve që kanë të drejtën e uzufuktit ose të drejtën e marrjes peng të aksioneve, duke përcaktuar datën e marrjes së kësaj të drejte, datën e panimit ose shërbimit.

4. Çdo aksionar, uzufuktar ose pengmarrës duhet të sigurohet që adresa e tyre t'i bëhet e ditur Shoqërisë.
5. Regjistri do të rinovohet rregullisht; në të do të regjistrohet çdo detyrim pagese i pashlyer.
6. Bordi administrativ do të japë falas me kërkesën e një aksionari, uzufuktari apo pengmarrësi pjesë nga regjistri, në lidhje me të drejtat e tij mbi aksionet.
7. Bordi administrativ do të dorëzojë regjistrin në zyrat e Shoqërisë për kontroll nga ana e aksionarëve. Informacioni i regjistrit në lidhje me aksionet e papaguara plotësisht nuk do t'i jepet askujt, kopje ose pjesë të këtij informacioni do të jepen vetëm me çmimin e kostos.

## UZUFUKTI DHE E DREJTA E PENGUT MBI AKSIONET MANDATI I DEPOZITIMIT TË AKSIOEVE

### Neni 10

1. Për aksionet mund të krijohet një uzufukt ose peng
2. Uzufuktaret dhe pengnarrësit e aksioneve nuk kanë të drejtë të kërkojnë të drejtën e votës mbi aksionet.
3. Uzufuktaret dhe pengmarrësit nuk gëzojnë të drejtat që ligji i jep zotëruesve të mandatit të depozitimit të aksioneve të emetuara në bashkëpunim me Shoqërinë.
4. Shoqëria nuk është e autorizuar të garantojë bashkëpunimin e saj për emetimin e mandateve të depozitimit të aksioneve.

## TRANSFERIMI I AKSIOEVE

### Neni 11

1. Aksionet mund të transferohen vetëm me vendim të posaçëm të noterizuar para një noteri publik që vepron në Hollandë, para të cilit individët e përfshirë paraqiten si palë.
2. Shoqëria miraton transferimin e aksioneve me anë të këtij vendimi ose duke dorëzuar një kopje të noterizuar ose pjesë të vendimit, bashkëngjitur këtij dokumenti vendoset edhe një deklaratë e po asaj date.
3. Transferimi i bëhet e ditur Shoqërisë duke i dërguar kopje të noterizuar ose pjesë të vendimit.
4. Nëse Shoqëria është në djeni për një transferim të aksioneve ajo mund të njohë aktin ligjor si të sajën duke regjistruar marrësin e aksioneve në regjistrin e aksionarëve për atë sa njohja nuk është kërkuar dhe as kalimi nuk është kryer. Shoqëria menjëherë njofton me shkrim palët e përfshira në aktin ligjor duke i dërguar kopje ose pjesë të vendimit. Pas marrjes së tij bëhet një shënim në dokumentin e marrë; data e regjistrimit do të merret edhe si datë e njohjes së vendimit.
5. Transferimi përfshin krijimin, dorëheqjen dhe kalimin e së drejtës së uzufuktit mbi aksionet, krijimin dhe dorëheqjen nga e drejta e pengut mbi aksionet dhe marrjen për llogari të njëres palë.

6. Gjithashtu transferimi quhet i vlefshëm ligjërisht edhe në lidhje me Shoqërinë. Përveç rasteve kur vetë Shoqëria është palë e aktit ligjor, të drejtat e aksioneve mund të ushtrohen pas njohjes së aktit ligjor sipas këtij neni ose pasi vendimi të jetë zbatuar, ose pasi të jetë të regjistruar në regjistrin e aksionarëve ashtu siç parashikohet në paragrafin 4.

## KUFIZIME MBI TRANFERIMIN E AKSIONEVE

### Neni 12

1. Aksionet mund të transferohen vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
2. Nëse një aksionar, më poshtë në këtë nen i referuar si “aplikanti”, kërkon të transferojë një ose më shumë aksione, bordi i drejtorëve kërkon miratimin e transferimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, nëse kjo kërkesë nuk miratohet, atëherë vetë aplikanti duhet ta kërkojë këtë gjë.
3. Miratimi do të quhet i vlefshëm nëse:
  - a. kanë kaluar jo më pak se 3 muaj nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim dhe ky vendimi do t’i njoftohet me shkrim aplikantit;
  - b. aplikanti njoftohet me shkrim se cili nga blerësit e mundshëm është të gati të paguajë me para dorë, përveç rasteve kur aplikanti në të njëjtën kohë është njoftuar për refuzimin e kërkesës.
4. Çmimi i blerjes do të përcaktohet nga aplikanti, ndërsa blerësi i mundshëm do të përcaktohet në bashkëpunim me Shoqërinë dhe në rast se kjo gjë nuk arrihet, do të përcaktohet nga një ekspert i pavarur i emëruar nga palët, ose në rast të kundërt do të përcaktohet nga Gjykata Rajonale (Subdistrict) e atij vendi zone ku ndodhet selia e Shoqërisë, me kërkesën e palës më të andazhuar. Aplikanti mund të refuzojë deri brenda një muaji pas njoftimit të çmimit të vendosur.
5. Shoqëria mund të jetë blerëse e mundshme me miratimin e aplikantit.
6. Transferta bëhet brenda 3 muajve pas marrjes së miratimit.
7. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen nëse aksionari është i detyruar ligjërisht t’i transferojë aksionet e tij një aksionari tjetër.
8. Bordi i drejtorëve administrativ, të paktën në herë në vit, duhet t’i sigurojë bordit të drejtorëve të mbikëqyrjes të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij.

## BORDI I DREJTORËVE DHE BORDI MBIKËQYRËS

### Neni 13

1. Shoqëria administrohet nga një bord i drejtorëve i përbërë nga një ose më shumë drejtorë të mbikëqyrur nga bordi mbikëqyrës i cili përbëhet nga të pakën 3 anëtarë. Nëse ka më pak se 3 drejtorë mbikëqyrës, bordi duhet të marrë menjëherë masa për plotësimin e numrit të anëtarëve të tij.
2. Bordi i drejtorëve cakton detyrat e tij duke u këshilluar me bordin mbikëqyrës. Me miratimin e bordit mbikëqyrës, bordi i drejtorëve mund të hartojë rregullore me anë të të cilave rregullohen çështjet e brendshme të bordit administrativ.
3. Bordi i drejtorëve mund të marrë vendime në dhe jashtë mbledhjeve. Vendimet jashtë mbledhjeve mund të merren vetëm nëse të gjithë drejtorët kanë mundur të gjykojnë çështjen në fjalë.

4. Bordi i drejtorëve vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.
5. Pa cënuar dispozitat e tjera të këtij neni të Statutit të Shoqërisë, bordi i drejtorëve kërkon miratimin e bordit mbikëqyrës për çështjet e mëposhtme:
  - a. për emetimin dhe marrjen e aksioneve në shkëmbim të detyrimeve të Shoqërisë ose në shkëmbim të detyrimeve të një ortakërie të pjeshme ose të një shoqërie tjetër me të cilën Shoqëria ka partneritet të plotë;
  - b. bashkëpunimin për çështje të regjistrimit të mandateve të depozitimit të aksioneve;
  - c. aplikim për listim ose tërheqje të listimit të detyrimeve të parashikuara në paragrafin a dhe mandatet e depozitimit të parashikuar në paragrafin b në listën zyrtare të çdo burse;
  - d. të lidhë ose të shkëputet nga bashkëpunime të qëndrueshme të Shoqërisë ose të një dege të shoqërisë me një subjekt juridik ose shoqëri tjetër ose si ortak me përgjegjësi të plota në një partneritet të kufizuar ose shoqëri partnere, në rast se ky bashkëpunim ose shkëputje ka një rëndësi të madhe për Shoqërinë;
  - e. të ketë të drejtën e pjesëmarrjes në shumën sa të paktën  $\frac{1}{4}$  e kapitalit të deklaruar me rezervat sipas bilancit të Shoqërisë të shoqëruar me shënime shpjeguese, ose pjesëmarrjen e një dege të shoqërisë në kapitalin e një shoqërie tjetër dhe rritjen ose zvogëlimin drastik të kësaj pjesëmarrjeje;
  - f. investimet që kërkojnë një shumë të barabartë me të paktën  $\frac{1}{4}$  e kapitalit të deklaruar me rezervat e Shoqërisë sipas bilancit të saj;
  - g. propozim për ndryshimin e Statutit;
  - h. propozim për prishjen e Shoqërisë;
  - i. depozitimin në rast falimentimi dhe aplikimin për shtyrje të afatit të pagesës;
  - j. zgjidhjen e kontratës së punës në të njëjtën kohë ose brenda një kohe të shkurtër të një numri të konsiderueshëm punonjësish të Shoqërisë ose të një dege;
  - k. ndryshimin drastik të kushteve të punës të një numri të konsiderueshëm punonjësish të Shoqërisë ose të degëve;
  - l. propozim për zvogëlimin e kapitalit të emetuar.
6. Bordi i drejtorëve kërkon për më tepër, miratimin e bordit mbikëqyrës në lidhje me vendimet për çështje të cilat Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka vendosur që vendimet e bordit të drejtorëve në lidhje me këto çështje duhet t'i nënshtrohen miratimit të bordit mbikëqyrës.
7. Mungesa e miratimit për vendime të parashikuara në paragrafin e mësipërm nuk ndikojnë në autoritetin e bordit të drejtorëve ose drejtorëve.
8. Bordi mbikëqyrës jep udhëzime për mbarëvajtjen e përgjithshme të politikave financiare, sociale, ekonomike dhe të personelit që duhen ndjekur.
9. Në rast mungese ose paafësie për pjesëmarrjen e të gjithë drejtorëve administrativ dhe përkatësisht drejtorit të vetëm, administrimi do t'i besohet përkohësisht bordit mbikëqyrës, në rast se Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk ka emëruar një individ të posaçëm për këtë qëllim. Nëse bordi mbikëqyrës drejton përkohësisht administrimin e Shoqërisë, ai mund t'ja kalojë këtë detyrë një ose më shumë individëve nga ose jashtë anëtarëve të tij.



## PËRFAQËSIMI

### Neni 14

1. Bordi i drejtorëve përfaqëson Shoqërinë. Gjithastu, çdo drejtor veçmas autorizohet të përfaqësojë Shoqërinë.
2. Nëse një ose më shumë drejtorë hyjnë në marrëveshje private me Shoqërinë ose ndërmarrin privatisht veprime kundër Shoqërisë, atëherë Shoqëria përfaqësohet nga drejtori mbikëqyrës i emëruar nga bordi mbikëqyrës për këtë qëllim, përveç rasteve kur Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka emëruar një ose më shumë individë për këtë detyrë; gjithashtu mund të emërohet edhe drejtori prej të cilit ka lindur ky konflikt interesash. Nëse një ose më shumë drejtorë kanë konflikt interesash me interesat e Shoqërisë në një mënyrë tjetër ndryshe nga ajo e përcaktuar në fjalinë e parë të këtij paragrafi, drejtorët dhe bordi mbikëqyrës nuk e humbasin të drejtën e përfaqësimit.

## EMËRIMI, PEZULLIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORËVE ADMINISTRATIV

### Neni 15

1. Drejtorët administrativ emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, e cila gjithashtu oërcakton edhe numrin e tyre.
2. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka të drejtë të pezullojë drejtorët administrativ në çdo kohë.
3. Bordi mbikëqyrës ka gjithastu të drejtë të pezullojë drejtorët administrativ në çdo kohë.

Në rast se pezullimi nuk kryhet paraprakisht, do të mbahet një mbledhje e zakonshme e aksionarëve brenda një muaji gjatë së cilës do të shqyrtohet pezullimi. Mosmbajtja e kësaj mbledhjeje do të shkaktojë rrëzimin e pezullimit.

Nëse në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve nuk arrihet pezullimi ose shkarkimi i drejtorit administrativ, pezullimi rrëzohet.

Vendimi për pezullim mund të merret vetëm një herë dhe mund të merret brenda një periudhe tre mujore, dhe hyn në fuqi nga data e marrjes së vendimit në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve.

## EMËRIMI, PEZULLIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORËVE MBIKËQYRËS

### Neni 16

1. Drejtorë mbikëqyrës nuk mund të jenë:
  - a. Persona të punësuar nga shoqëria;
  - b. personat e punësuar nga një shoqëri vartëse;
  - c. administratorët dhe personat e punësuar nga një organizatë punësimi e cila zakonisht merret me vendosjen e kushteve të punësimit të personave që përmenden në pikat a dhe b.
2. Duke i qëndruar dispozitave në paragrafin 5, drejtorët mbikëqyrës do të emërohen nga bordi i drejtorëve në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve, për aq sa emërimi nuk është bërë më parë me aktin e themelimit ose përpara se ky nen të zbatohet nga shoqëria. Emërimi duhet të jetë i arsyetueshëm.
3. Bordi i drejtorëve mbikëqyrës përpilon një skicë të detajuar për përbërjen dhe numrin e tyre, duke patur parasysh llojin e shoqërisë, veprimtarinë e saj,

- ekspertizën dhe formimin e drejtorëve mbikëqyrës. Bordi i drejtorëve mbikëqyrës do të diskutojë skicën e detajuar në takimin e parë dhe më pas në mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve do të diskutojë për ndryshimet e tij.
4. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve dhe këshilli i punës mund të rekomandojë individë bordit mbikëqyrës për tu emëruar si drejtor mbikëqyrës. Bordi mbikëqyrës do të njoftojë ata nëse do të ketë nevojë për plotësime të vendeve vakante. Në rast se për vendin vakant aplikohet e drejta e rekomandimit sipas paragrafit 5, bordi mbikëqyrës gjithashtu duhet ta bëjë këtë të ditur. Bordi mbikëqyrës do të njoftojë për emërimin njëherazi në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve dhe pranë këshillit të punës.
  5. Zbatohet tek një e treta e numrit të anëtarëve të bordit mbikëqyrës se bordi mbikëqyrës vendos një person të rekomanduar nga këshilli i punës për emërimin, vetëm nëse bordi mbikëqyrës kundërshton rekomandimin në bazë të parashikimeve se personi i rekomanduar nuk arrin të kryejë detyrën e drejtorit mbikëqyrës ose nëse bordi mbikëqyrës funksionon sic duhet me metodëne rekomandimeve. Nëse numri i anëtarëve të bordit mbikëqyrës nuk ndahet në tre, numri më i pakët i nevojshëm që mund të ndahet nga tre mund të merret në konsideratë për përcaktimin e numrit të anëtarëve për të cilët zbatohet e drejta e rekomandimit.
  6. Nëse bordi mbikëqyrës kundërshton, ai njofton këshillin e punës duke përcaktuar edhe arsyet. Bordi mbikëqyrës menjëherë duhet të kshillohet me këshillin e punës për të arritur një marrëveshje për emërimin.
  7. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të refuzojë emërimin me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të cilët duhet të përfaqësojnë të paktën 1/3 e kapitalit të deklaruar. Nëse të paktën 1/3 e kapitalit të deklaruar nuk është e përfaqësuar në mbledhje, atëherë duhet të mbahet një mbledhje tjetër ku emërimi mund të refuzohet me shumicë absolute të votave. Bordi mbikëqyrës duhet të propozojë një emërim të ri. Paragrafet nga 4 deri te 6 do të zbatohen sipas rastit. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk emëron individin e propozuar dhe as nuk vendos të refuzojë emërimin, bordi mbikëqyrës vendos të emërojë individin e propozuar.
  8. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund t'i kalojë autoritetin e dhënë sipas paragrafit 4, një këshilli aksionarësh, anëtarët e të cilit përcaktohen nga Asambleja, për një afat që përcaktohet nga vetë Asambleja dhe çdo mandat maksimumi deri në 2 vjet; në rast të tillë bordi mbikëqyrës njofton këshillin sipas paragrafit 4. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mundet në çdo kohë të anultojë kalimin e kompetencave.
  9. Për miratimin e këtij neni këshilli i punës do të jetë i vetmi që nenkuptohet sipas konceptit të parashikuar në nenin 2:268, paragrafi 11 i Kodit Civil.
  10. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund ta humbasë besimin e saj nga bordi mbikëqyrës me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm që përfajsojnë të paktën 1/3 të kapitalit të deklaruar. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar. Vendimi nuk mund të merret në lidhje me drejtorët mbikëqyrës të emëruar sipas paragrafit në lidhje me shoqëritë të nenit 2:271 të Kodit Civil.
  11. Ky vendim do të merret vetëm pasi bordi të njoftojë Këshillin e Punës për propozimin e bërë si dhe për arsyet e tij.

12. Njoftimi do të bëhet të paktën 30 ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme ku do të diskutohet ky propozim. Nëse Këshilli i punës merr një vendim, bordi njofton bordin mbikëqyrës dhe Asamblenë e Përgjithshme për këtë gjë. Këshilli i punës duhet të shpjegojë pikëpamjet e tij në Asamble.
13. Vendimi çon në shkarkimin e menjëhershëm të anëtarëve të bordit mbikëqyrës. Atëherë bordi mund t'i kërkojë Gjykatës së Apelit të Shoqërive Trgtare në Amsterdam të emërojë një ose më shumë drejtorë mbikëqyrës.
14. Bordi mbikëqyrës, gjithashtu është i autorizuar të pezullojë drejtorët administrativ në çdo kohë. Nëse pezullimi nuk anulohet më parë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mblidhet brenda një muaji për të anuluar pezullimin. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk vendos as të vazhdojë pezullimin dhe as vendos për shkarkimin, pezullimi anulohet. Vendimi për vazhdimin e pezullimit mund të merret vetëm një herë dhe peridha e pezullimit mund të zgjasë jo më shumë se 3 muaj, duke nisur që nga data e marrjes së këtij vendimi nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.
15. Nëse një drejtor mbikëqyrës ka qenë në detyrë për një periudhë 4 vjeçare qysh nga emërimi i tij i fundit, ai mund të japë dorëheqjen jo më vonë se ditën e mbledhjes së radhës së Asmblesë pas mbarimit të mandatit të tij 4 vjeçar ose një ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
16. Bordi mbikëqyrës, në çdo kohë mund të autorizohet të hartojë një listë për dorëheqjen.

## **SHPËRBLIMI I DREJTORËVE ADMINISTRATIVË DHE MBIKËQYRËS**

### **Neni 17**

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendos për çdo drejtor administrativ në veçanti pagën e tij si dhe kushte të tjera të punësimit.
2. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve cakton për çdo drejtor mbikëqyrës pagën e tij.

## **BORDI MBIKËQYRËS**

### **Neni 18**

1. Bordi mbikëqyrës ka për detyrë të mbikëqyrë politikat e vordit administrativ si dhe ecurinë e përgjithshme të çështjeve të Shoqërisë dhe veprimtative tregtare të lidhura me të. Ai këshillon bordin administrativ. Gjatë kryerjes së detyrave drejtorët mbikëqyrës veprojnë në përputhje me interesat e Shoqërisë si dhe veprimtarive të lidhura me të.
2. Bordi mbikëqyrës zdhedh nga anëtarët e tij kryetarin dhe nga ose jo prej anëtarëve të tij një sekretar. Nëse kryetari nuk është i pranishëm në një mbledhje, bordi zgjedh kryetarin e mbledhjes.
3. Bordi mbikëqyrës mblidhet sa herë një drejtor mbikëqyrës e quan të nevojshme. Drejtorët administrativ janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e bordit mbikëqyrës nëse ju kërkohet si dhe të japin të gjithë informacionin e kërkur.
4. Bordi mbikëqyrës merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.
5. Bordi mbikëqyrës mirato vendime të vlefshme vetëm nëse shumica e anëtarëve të bordit janë të pranishëm ose të përfaqësuar në takim.

6. Bordi mbikëqyrës mund të marrë vendime jashtë zyre, me anë të telegrafit, teleteksit, telefaksit ose me mënyra të tjera komunikimi, nëse bëhen me shkrim dhe nëse të gjithë drejtorët mbikëqyrës janë pro propozimit në fjalë.
7. Bordi mbikëqyrës është i autorizuar të kontrollojë regjistrat, protokollet si dhe të dokumente të tjera Shoqërisë. Bordi administrativ pajis bordin mbikëqyrës me të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
8. Drejtorët administrativ të pakëtn një herë në vit i ofrojnë drejtorëve mbikëqyrës të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre.

#### INDIVIDËT E AUTORIZUAR ME PROKURË

##### Neni 19

Bordi administrativ pajis me prokurë një ose më shumë individë të autorizuar për një funksion të caktuar.

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

##### Neni 20

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mbledhet të paktën një herë në vit. Brenda 6 muajsh pas përfundimit të vitit finaciari, Asambleja e Përgjithshme miraton llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimit dhe diskuton raportin vjetor dhe nëse kërkohet me ligj hartohet një raport vjetor, përveç rastit kur perudha për hartimin e llogarive vjetore është zgjatuar me vendim të Asmblesë sipas nenit 27, paragrafi 2.
